

**Përmbledhje jo Teknike
Raport i VNM-së**

**Impliant Energjitik me Cikel të Kombinuar
Roskovec, Shqiperi**

FIER THERMOELECTRIC“ SHA



Qershor , 2023

Perfituesi	FIER THERMOELECTRIC“ SHA
Konsulenti:	“Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k
Titulli i Projektit:	Impiant Energjitik me Cikel të Kombinuar Roskovec, Shqiperi
Titulli i Dokumentit:	Përmbledhje jo Teknike e Raportit të Vlerësimit të Thelluar të Ndikimit në Mjedis

1. HYRJE, KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI PROJEKTIN.....	8
1.1 QËLLIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.....	8
2. KUADRI LIGJOR.....	9
2.1 KUADRI LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL QË LIDHET ME PROJEKTIN	9
2.2 PËRMBLEDHJA E KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	10
2.3 STANDARTET INTERNACIONALE TE REKOMANDUARA	14
3. TE DHENA TEKNIKE MBI PROJEKTIN	16
3.1 QELLIMI I PROJEKTIT.PERSHKRIM I PERGJITHSHEM I PROJEKTIT TEKNIK	16
4. PERSHKRIMI I VENDODHJES SE PARKUT ENERGJITIK	17
4.1 PERSHKRIM I PERGJITHSHEM I ZONES SE PROJEKTIT	17
4.1.1 Koordinatat dhe sipërfaqja e zones se projektit	18
4.2 INFORMACIONIN PËR QENDRAT E BANUARA NË ZONËN E PROJEKTIT.....	18
4.2.1 Njësia vendore administrative e zonës së projekti	18
4.2.2 Distanca e zonës së projektit nga qendrat e banuara.....	20
4.2.3 Trashëgimia kulturore ne zonen e projektit	21
4.3 BIODIVERSITETI NE ZONEN E PROJEKTIT.....	24
4.4 INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË TIJ	28
4.5 PËRSHKRIM I ZONAVE TË MBROJTURA,MONUMENTET E NATYRËS DHE OBJEKTET E TRASHËGIMISË KULTURORE	29
4.5.1 Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës.....	29
4.6 INTERFERENCA E ZONES SE PROJEKTIT ME AKTIVITETET MINERARE	34
4.7 INFRASTRUKTURA RRUGORE PRANE ZONES SE PROJEKTIT	35
4.8 CILËSIA E AJRIT URBAN	36
4.9 MBETJET BASHKIAKE	36
4.9.1 Forcat shtytëse, presionet, reagimi, ndikimi	37
5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS. MASAT PARANDALUESE PER ZBUTJEN E NDIKIMIT.....	39
5.1 PERMBLEDHJE E NDIKIMEVE POTENCIALE	39
5.1.1 Faza ndertimore & Operacionale e Projektit	39
6. PËRSHKRIM I SHKURTËR MBI SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, SI DHE PRODHIMIN E MBETJEVE	46
6.1 SHKARKIMET NE AJER	46
6.2 MBETJET E GJENERUARA	46
6.3 UJËRAT E NDOTURA DHE SHKARKIMET	47
6.4 EMETIME ZHURMA	47
6.4.1 Shkarkimet ne toke	50
7. INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA	51
7.1 KOHËZGJATJEN E MUNDSHME E NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA	51
7.1.1 Vlerësimi i Rëndësisë së Ndikimeve Negative Mjedisore	51
8. SHTRIRJA E MUNDSHME HAPËSINORE E NDIKIMEVE NEGATIV NË MJEDIS, QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË	55
8.1 INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA	55
9. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR	58
9.1 PLANI I REHABILITIMIT MJEDISOR.....	58
9.1.1 Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e secilës masë të propozuar	59

9.2	PLANI PER MBROJTJEN E SHENDETIT DHE SIGURISE SE NJEREZVE	63
9.2.1	Baza Ligjore	63
9.2.2	Vlerësimi i riskut.....	63
9.2.3	Punimet në lartësi	64
9.2.4	Kujdesi mjekësor	64
9.2.5	Siguria elektrike.....	65
9.2.6	Rastet aksidentale, rënia e zjarrit	65
9.2.7	Ngritja e peshave në mënyrë manuale	66
9.2.8	Ndihma e parë.....	66
9.2.9	Substancat e rrezikshme	66
9.2.10	Dëmtimet nga rrëshkitjet.....	67
9.2.11	Sigurimi teknik i objektit	67
9.2.12	Plani i emergjencave	67
9.2.13	Sinjalistika	71
10.	MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.....	74
10.1	NDRYSHIM I DESTINACIONIT TE PERDORIMIT TE TOKES	74
10.2	SHKARKIMET NE AJER	74
10.3	MBETJET E GJENERUARA	77
10.4	UJËRAT E NDOTURA DHE SHKARKIMET	78
10.5	KONSUM I BURIMEVE NATYRORE	79
10.6	NDIKIME NE ZHURMA.....	79
10.7	NDIKIMI SOCIAL-EKONOMIK I PROJEKTIT	81
10.8	IMPAKTI VISUAL.....	81
10.9	IMPAKTI NE TRASHEGIMINE KULTURORE DHE ARKEOLOGJIKE	81
11.	PERFUNDIME	83
	Tabela 2-1:Përmbledhja e kuadrit ligjor dhe institucional.....	10
	Tabela 4-1:Ne vijim po paraqesim objektet e rëndësishme te trashëgimise kulturore te qarkut te Fierit ..	22
	Tabela 4-2:Baza e të dhënave e përditësuar e monumenteve të natyrës.....	29
	Tabela 4-3:Bashkitë dhe impiantet e depozitimit përfundimtar të mbetjeve.....	36
	Tabela 4-4:Gjendja e kimikateve në subjekte të ndryshme	38
	Tabela 4-5:Magazinat e kimikateve në vend, lloji i kimikateve që ato kanë të depozituar.....	38
	Tabela 4-6:Pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri	38
	Tabela 5-1:Bilanci i shkarkimeve ne ajër (prurja ne mase)	40
	Tabela 5-2:Perbërja e gazrave te shkarkimeve	40
	Tabela 5-3: Bilanci i shkarkimeve ne ajër (prurja ne mase)	46
	Tabela 5-4:Perbërja e gazrave te shkarkimeve	46
	Tabela 7-1:Metodika e vlerësimit të rëndësisë së ndikimeve të mundshme negative në mjedis.....	51
	Tabela 7-2:Pesha , volumi dhe kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar	53
	Tabela 7-3:Pesha , volumi dhe shtrirja e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar	56
	Tabela 9-1:Operacioneve , ne vijim si vijon:	59
	Tabela 9-2:Masat për zbutjen e ndikimeve	59
	Tabela 9-3:Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e secilës masë të propozuar	59
	Tabela 10-1:Normat e cilësisë së ajrit për qëndrat e banuara	74
	Tabela 10-2:Bilanci i shkarkimeve ne ajër (prurja ne mase).....	75
	Tabela 10-3:Perbërja e gazrave te shkarkimeve	75
	Tabela 10-4:Nivelet kufi te zhurmes per mjediset e caktuara	80

Figure 1-1:Harta topografike e zones se propozuar te projektit	8
Figure 4-1:Harta topografike e zones se propozuar te projektit	17
Figure 4-2:Koordinatat e zones se projektit	18
Figure 4-3:Njesite adminsitrative te zones se projektit	18
Figure 4-4:Njesia administrative Roskovec	20
Figure 4-5:Distanca e zonës së projektit nga qendrat e banuara	20
Figure 4-6:Institucionet Publike dhe Arsimore referuar zones se projektit	21
Figure 4-7:Vendodhjet e monumenteve te kultures (pikat me te verdha) perreth zones se projektit(rrethi i kuq)	24
Figure 4-8:Kishes se Shen Kollit ne Kurjan.	24
Figure 4-9:Ortofoto e vendodhjes se impiantit	25
Figure 4-10:Foto nga bimesia e zones se projektit	28
Figure 4-11:Burimet ujore siperfaqesore prane zones se projektit.....	28
Figure 4-12:Selvite e Manastirit et Ardenices Rrapi i Zonjes Bubullime.....	30
Figure 4-13:Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyres referuar gjurmes se projektit	31
Figure 4-14:Monumentet e natyres referuar gjurmes se projektit	32
Figure 4-15:Monumentet e natyres referuar gjurmes se projektit(gjurma e projektit rrethi me te kuqe).33	33
Figure 4-16:Zonat minerare referuar zones se projektit	34
Figure 4-17:Zonat hidrokarbure prane zones se projektit.....	35
Figure 4-18: Rrjeti rrugor lokal dhe kombetar ne lidhje me zonen e propozuar te projektit.....	36
Figure 5-1:Turbina me avull dhe gjeneratori (STG) i inkooporuar ne kapake per reduktimin e zhurmes .49	49
Figure 5-2:Silenciatorët vertikalë në oxhak dhe silenciatorët horizontalë brenda HRSG	49
Figure 7-1:Fshatrat e ndikuara referuar zones se projektit.....	55
Figure 9-1:Spill kit per pastrimin e derdhjeve.....	71

Fjalori I Termave

- CCGT :Termocentral i Ciklit të Kombinuar / Combined Cycle Power Plant (CCPP)
- CCGT: Combined Cycle Gas Turbine (Turbine Gazi me cikël të kombinuar)
- DEPA : Public Gas Corporation of Greece (Korporata Publike e Gazit të Greqisë)

Në termocentrale si lëndë djegëse përdoret thëngjilli, vajguri ose gazi natyror. Në fillim si lëndë djegëse është përdorur vajguri por me rritjen e konsumimit të benzinës për automobila por me rritjen e çmimit kjo doli nga përdorimi, kurse sot përdorim të ***madh ka gazi natyror sepse prodhimi i dioksidit të sulfurit, shirave acidike dhe trajtimi i hirit nuk shfaqin problem dhe për ambientin është shumë më mirë.***

“Gaz natyror” është gazi metan, përshirë gazin shoqërues, si dhe të gjitha hidrokarburet që janë në gjendje të gaztë, në kushte atmosferike normale, i cili, përfshin edhe GNL-në, biogazin ose lloje të tjera gazi, që transmetohen dhe shpërndahen në sistemin e tubacioneve.

“Hidrokarbur” është nafta bruto dhe/ose gazi natyror.

“Autoriteti përkatës i qeverisjes vendore” është njësi e qeverisjes vendore në territorin e së cilës është vendosur instalimi.

“Agjencia Kombëtare e Mjedisit” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

“Agjencia rajonale e mjedisit” është njësi rajonale përkatëse e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

“Gjendje e pranueshme e mjedisit” është gjendja në të cilën mjedisi i vendit në fjalë ishte para se instalimi të vihej në operim. Arritja e kësaj gjendjeje kërkon masa që përfshijnë, por nuk kufizohen me: largimin e të gjitha mbetjeve që kanë tepruar, largimin sa më shumë të jetë e mundur të çdo lloj ndotjeje, dhe, aty ku ky largim nuk do të thotë trajtim praktik apo stabilizim i ndotjes, rehabilitimin e çdo dëmi që mund të ketë shkaktuar ndotja, si dhe zbutjen e efekteve të çdo dëmi.

“Instalim” është çdo njësi teknike e palëvizshme, që kryen një ose shumë veprimtari, si dhe çdo lloj tjetër veprimtarie që lidhet drejtpërdrejt me të apo ka një lidhje teknike me veprimtaritë e zhvilluara në njësinë e mësipërme dhe që mund të ndikojë në shkarkimet dhe ndotjen;

“Leje mjedisi e tipit A” është leja për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin 1/A, e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, të lëshuar nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit A, sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator.

“Mjedis” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

“Ndotje” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

“Normat e cilësisë së mjedisit” është një grup kushtesh që duhen përmbushur në një kohë të dhënë nga një mjedis i caktuar ose një pjesë e veçantë e tij, sipas përcaktimit të ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

“Normat teknike të shkarkimit në mjedis” janë vlerat teknike kufi të shkarkimit, që lidhen me teknologjinë e prodhimit, makineritë dhe pajisjet në përdorim, sipas përcaktimit të ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

“Operator” është personi fizik apo juridik që operon ose kontrollon instalimin, apo të cilit i është deleguar fuqi ekonomike vendimtare për funksionet teknike të instalimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Si operator i një instalimi, që:

a) nuk është vënë ende në funksionim, konsiderohet personi që do të kontrollojë funksionimin e tij në të

ardhmen;

b) nuk funksionon më, konsiderohet personi të cilit i ishte dhënë leje mjedisi për funksionimin e këtij instalimi. “Publik” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

“Shkarkim” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

“Shkarkim në ujë” janë shkarkimet në trupat ujorë, ku përfshihen shkarkimet në rrjetin e tubacioneve të ujërave të zeza e të bardha.

“Teknikat më të mira të disponueshme (TMD)” është stadi më efektiv dhe më i përparuar i zhvillimit të veprimtarive dhe të metodave të operimit të tyre. Ky stad tregon se sa të përshtatshme janë praktikisht teknikat e veçanta për të siguruar, në parim, bazën për të përcaktuar vlera kufi të shkarkimeve, të tilla që të parandalojnë dhe, kur nuk është praktikisht e mundshme, të pakësojnë shkarkimet në përgjithësi dhe ndikimin mbi mjedisin në tërësi.

Për qëllime të këtij përkufizimi, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

a) “Teknikë” është teknologjia dhe mënyra me të cilën instalimi është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur dhe çmontuar;

b) “Teknikë e disponueshme” janë teknikat e zhvilluara në atë nivel që mundëson përdorimin e tyre, në sektorin përkatës industrial, me rezultate të mira ekonomike e teknike. Vlerësimi i teknikave merr parasysh kostot dhe përparësitë, pavarësisht nga fakti nëse ato teknika përdoren apo prodhohen në Republikën e Shqipërisë, për sa kohë ato janë të arritshme nga përdoruesi;

c) “Më e mirë”, në lidhje me teknikat, është teknika më efektive për arritjen e një niveli të lartë të përgjithshëm të mbrojtjes së mjedisit në tërësi.

“Vlera kufi e shkarkimit” është masa e shprehur në disa parametra specifike, përqendrimet dhe/ose nivelet e shkarkimeve që nuk mund të tejkalohen në një ose më shumë periudha kohore.

“Impiant me djegie” është çdo aparaturë teknike, ku oksidohen lëndë djegëse, në mënyrë që të përdoret nxehtësia e gjeneruar.

“Lëndë djegëse” është çdo material i djegshëm, i ngurtë, i lëngshëm apo i gaztë, i përdorur në instalimin me djegie, me përjashtim të mbetjeve, sipas përcaktimit të legjislacionit të posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

“Mbetje të gazta” janë shkarkime të gazta, që përmbajnë substanca të ngurta, të lëngshme ose të gazta; fluksi vëllimor i tyre do të shprehet në $m^3/orë$, në temperaturën standard ($273^{\circ}K$) dhe presion ($101,3\text{ kPa}$) pas korigjimit të përmbajtjes së avullit të ujit, (më poshtë referuar si Nm^3/h).

“Njësi djegieje me shumë lëndë djegëse” është çdo impiant djegieje, ku mund të digjen njëkohësisht ose në mënyrë të alternuar dy a më shumë lloje lëndësh djegëse.

“Përqindja e desulfurizimit” është përqindja e sasisë së squfurit që nuk shkarkohet në ajër, në instalimin me djegie, për një periudhë të dhënë kohe ndaj sasisë së squfurit në përmbajtjen e karburantit, të përdorur gjatë së njëjtës periudhë kohe, në këtë instalim.

“Turbinë me gaz” është çdo makineri rrotulluese që shndërron energjinë termike në punë mekanike dhe përbëhet kryesisht nga një kompresor, një njësi termike ku oksidohet lënda djegëse, në mënyrë që të ngrohë masën e lëngshme të punës, dhe një turbinë.

“Vlera kufi e shkarkimit” është sasia e lejueshme e një substance në masën e gaztë të shkarkuar në ajër nga instalimi me djegie, gjatë një periudhe të dhënë. Sasia e substancës llogaritet në terma të masës/për vëllim të gazeve të shkarkuara, të shprehura në mg/Nm^3 , duke konsideruar një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara: prej 3 për qind, në rastin e karburanteve të lëngshme e të gazta, 6 për qind në rastin e karburanteve të ngurta dhe 15 për qind në rastin e turbinave me gaz.

1. HYRJE, KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI PROJEKTIN

1.1 Qëllimi i Projektit të Propozuar

Shoqëria “ FIER THERMOELECTRIC“ SHA , person juridik shqiptar identifikuar ne rregjistrin tregetar me NUIS Nr M22211019U , synon te zhvillojë projektin e **ndertimit dhe funksionimit te Termocentralit me Turbinë Gazi me Cikli të Kombinuar (CCGT), me gaz natyror si lëndë djegëse, me kapacitet 170 MW**, me një teknologji moderne të prodhimit të energjisë me efikasitet të lartë 57% me ngarkesë maksimale.

Vendndodhja e impiantit do të jetë në zonën e Roskovecit pranë Fierit në Shqipëri dhe pranë Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) dhe pranë Rrjetit Elektrik të Tensionit të Lartë.

Zhvillimi i ketij projekti dhe veprimet e mbështetura prej tij do të sjellin një rritje të prodhimit të energjisë elektrike dhe do të diversifikojë prodhimin vendas. Paralelisht, ajo do të përmirësojë ekuilibrin në prodhim midis hidrocentraleve dhe burimeve të rinovueshme të energjisë dhe do të ketë një siguri të mbrojtur furnizimi për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë me Gazsjellësin Trans Adriatic.

Përveç kësaj, zhvillimi i ketij projekti do të reduktojë varësinë e tepërt nga importet e energjisë elektrike dhe të gjitha këto përfitime do të ofrojnë një treg më të favorshëm dhe të qëndrueshëm të energjisë në Shqipëri, duke tërhequr investime të huaja shtesë në energji dhe do të përmirësojnë perspektivat e rritjes ekonomike të Shqipërisë.

Vendodhja e propjektit te propozuar shtrihet ne një zonë rurale , pjese administrative e Bashkise Roskoves, Qarku Fier. Ajo gjendet e distancuar rreth 3 km ne vije ajrore larg qytetit te Roskovecit , rreth 1 km ne vije ajrore larg fshatrave Jagodine dhe Suk i Siperem (Suk1).




Figure 1-1:Harta topografike e zones se propozuar te projektit

2. KUADRI LIGJOR

2.1 Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional që Lidhet me Projektin

Kuadri ligjor për Mbrojtjen e Mjedisit në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me standardet e BE-së.

Ky projekt do të implementohet në territorin e Bashkisë Roskovec.

Në bazë të ligjit nr. 10440 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”; Neni 9; “Projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis/ ku shprehimisht thuhet:

Procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen:

- a) **Projektet e listuara në shtojcën I /Pika 2.” Termocentrale ose instalime të tjera me djegie, me një prodhim nxehtësie prej 20 ose më shumë megavatesh”**

Nderkohe referuar kërkesave ligjore per Lejet e Mjedisit , Ligji Nr. 52/2020 “ Për Disa Ndryshime në Ligjin Nr.10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet E Mjedisit”, të ndryshuar, konkretisht referuar **shtojcës 1:**

Projekti i nënshtrohet procedures per leje tipi A në varësi të kapacitetit prodhues kufi ,

Industritë energjetike.ID 1.1 Instalimet me djegie. Energjia termike në hyrje është e barabartë ose më e madhe se 50 MË.(Kapaciteti kufi për lejet e tipit A)

Ndërkohë për hapje dhe shfrytëzim pusi per nevoja të shfrytëzimit te burimeve ujore per qëllime përdorimi industrial për nevoja te impiantit , kompani do duhet te pajiset me leje per Hapje pusi dhe shfrytëzim pusi referuar kerkesave ligjore VKM Nr 550 date 15.07.2020 “Per miratimin e formularëve te kërkesës per miratimin ne parim per dhënie me koncesnion të përdorimit te burimit uJOR/ e lejes autorizimit per përdorim burimi uJOR, veprimtari ndertimore ne brigje , veprimtari ne shtratine burimit ujore, shkakrime te lëngshëm përdorimin dhe ripërdorimin e urjave te përdorura , te ndotura, te dokumenteve shoqëruese , tëprocedures se shqyrtimit ete vendimmarrjes , te formateve te lejes , te autorizimit, te kushteve te posaçme dhe te afateve te vlefshmërisë se tyre.

Legjislacioni Shqiptar përcakton strukturën e përmbajtjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis që të jetë sa më konciz në informacionin që duhet të përfshijë sipas VKM 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”.

Ligji Nr. 10431 datë 10.03.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”. Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

2.2 Përmbledhja e Kuadrit Ligjor dhe Institucional

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër më specifiket që lidhen me projektin përmendim.

Tabela 2-1: Përmbledhja e kuadrit ligjor dhe institucional

Kuadri Ligjor	
Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011	“Për mbrojtjen e Mjedisit të ndryshuar”;
Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011	“Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”
Ligjit Nr. 12/2015	“Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011,
Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 ¹ LIGJ I azhurnuar me: -Ligjin Nr.44/2013, datë14.02.2013 -Ligjin Nr.60/2014, datë19.06.2014	“Për lejet e mjedisit”
Ligji Nr. 102/2015	“Për Sektorin e Gazit Natyror”; Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me gaz natyror të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu konkurrues dhe të integruar me tregjet rajonale e europiane, për një shërbim me cilësi të lartë, kosto të arsyeshme, si dhe duke respektuar kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.
Ligj nr. 7-2018, datë 15.2.2018,	“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 43/2015, për sektorin e energjisë elektrike”
Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”	“Per sektorin e energjise elektrike”, të ndryshuar, përcakton dokumentat ligjore që duhet të ofroj kompania e interesuar për aplikim; Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.
Ligji Nr. 61/2020	“Për Disa ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr.43/2015, “Për Sektorin e energjisë Elektrike”, Të ndryshuar
Ligjit nr.7/2018	“Mbi disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.43/2015 “Per sektorin e energjise elektrike””;
Ligji Nr.124/2015 (ndryshuar me ligjin nr.5/2019, datë7.2.2019)	“Për Eficiência e Energjisë”
Ligji Nr. 111/2012	“Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”
Ligji Nr.9362, datë 24.03.2005	“Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”

¹ Ky ligj është përafshuar plotësisht me këto direktiva: Direktiva 2008/1/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 15 Janarit 2008 “Mbi kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes”, e ndryshuar, Numri CELX: 32008L0001, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 24, datë 29.01.2008, fq. 8-29. Direktiva 2001/80/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 23 Tetorit 2001 “Mbi kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga instalimet e mëdha me djegie”, Numri CELEX: 32001L0080, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 309, datë 27.11.2001, fq. 1-21.

Ligj nr. 10463 dt. 22.09.2011	“Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”
ligji nr. 162/2014 i ndryshuar ²	“Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar
Ligji nr. 27/2016	“Për menaxhimin e kimikateve”.
Ligji Nr 155/2020	“Për ndryshimet klimatike”
Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002	“Për zonat e mbrojtura” I ndryshuar me:Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
Ligjit nr.9650, datë 16.05.2010,	”Per pyjet dhe sherbimin pyjor”;
Ligjit nr. nr.8318,datë 01.04.1998,	”Per dhenien me qira te tokes bujqesore,pyjore,te livadheve dhe kullotave qe jane pasuri shteterore”,te ndryshuar
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmës në mjedis
Ligji Nr. 107/2014, datë 31.7.2014	“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar me Ligjin Nr. 73/2015, datë 09.7.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”
Ligji nr.68/2014	,”Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.9587, date 20.07.2006, ”Per mbrojtjen e Biodiversitetit”, i ndryshuar”.
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	“Për mbrojtjen e biodiversitetit”
Ligjit nr.10138/11.05.2009,”	“Per shendetin publik”;
Ligji Nr. 9048, datë 07.04.2003	“Për Trashëgiminë Kulturorë”, i ndryshuar. Ky ligj ka për qëllim shpalljen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ne territorin e Republikës se Shqipërisë
Ligji nr.139/2015,	“Per veteqeverisjen vendore”, në zbatim të nenit 3 “Misioni i veteqeverisjes vendore”, nenit 4 “Parimet themelore te veteqeverisjes vendore”, nenit 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor”, nenin 9 “Te drejtat dhe pergjegjesite” dhe nenet 22 deri 28, i jepet mundësi zhvillimi territorial dhe social –ekonomik në njesitë e vetëqeverisjes vendore.
Në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë janë miratuar edhe disa ligje në kuadër të përfshirjes së vendit tonë në Protokolle dhe Marrëveshje të ndryshme. Ndër to përmendim	
Ligji Nr. 9672, datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimmarrje, si dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.
Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos në konventën për ndryshimet klimatike (UNFC).
Ligji nr. 10 436, dated 28.06.2011	”Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin per reduktimin e metejshem te shkarkimeve te SO2
Vendime të Këshillit të Ministrave	
VKM Nr 714 date 06.11.2019	“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e këshillit të ministrave nr. 686, datë 29.7.2015 ‘për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”’, të ndryshuar

² Ky ligj është përafshuar plotësisht me:

Direktivën e Parlamentit European dhe Këshillit 2008/50/KE, datë 21 maj 2008, “Për cilësinë e ajrit në mjedis dhe një ajër më të pastër në Europë”. Numri Celex 32008 L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, Nr. 152 datë 11.6.2008. Direktivën e Parlamentit European dhe Këshillit 2004/107/KE, datë 15 dhjetor 2004, “Për arsenikun, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e ambientit”, e ndryshuar. Numri Celex 32004L0107, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr. 23, datë 26.1.2005, faqe 3-16.

VKM 686, datë 29.7.2015	“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”
VKM 714, datë: 06.11.2019	“Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjësive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar”;
VKM Nr. 587, datë 7.07.2010	“Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
VKM Nr. 550 ,datë 15.07.2020	“Per miratimin e formularëve te kërkesës per miratimin ne parim per dhënie me koncesnion të përdorimit te burimit ujqor/ e lejes autorizimit per përdorim burimi ujqor, veprimtari ndertimore ne brigje , veprimtari ne shtratine burimit ujqore, shkakrime te lëngshëm përdorimin dhe ripërdorimin e urjave te përdorura , te ndotura, te dokumenteve shoqëruese , tëprocedures se shqyrtimit ete vendimmarrjes , te formateve te lejes , te autorizimit, te kushteve te posaçme dhe te afateve te vlefshmërisë se tyre.
VKM Nr. 676, datë 20.12.2002	“Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror”
VKM Nr.804, datë 4.11.2003	“Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje”
VKM Nr. 177, datë 31.3.2005	“Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujqore pritëse”
VKM Nr.435, datë 12.09.2002	“Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
VKM Nr.803, datë 4.12.2003	“Për standardet e cilësisë së ajrit”
VKM Nr.994, datë 02.07.2008	“Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”
VKM Nr. 271, datë 6.4.2016	“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, të ndryshuar.
VKM Nr. 408, datë 13.5.2015	“Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”
VKM. Nr. 671, datë 29.7.2015	“Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”
VKM Nr. 502, datë 13.7.2011	“Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit
VKM nr. 87, datë 14.2.2018,	“Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”
VKM nr. 69, datë 7.2.2018	“Për miratimin e kushteve dhe të procedurës për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit me gaz natyror”
VKM Nr. 417, datë 10.5.2017	“Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror, në përputhje me standardet minimale të sigurisë së furnizimit, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm me gaz natyror”
VKM nr 755, datë 12.11.2014	“Për përcaktimin e procedurave e të kushteve për dhënien e “Licencës së përpunimit” për impiantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës”
VKM Nr 162, date 19.02.2020	“Per rregullat e hollësishe per hartimin miratimin rishikimin dhe zbatimin e programeve te pakësimit te shkarkimeve ne ajër”

VKM Nr. 412, datë 19.6.2019	“Për Miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit”
VKM Nr. 633, datë 26.10.2018	“ Për Masat Kundër Ndotjes së Ajrit nga Shkarkimet e Mjeteve Motorike dhe Reduktimin e Shkarkimeve në Ajër të Ndotësve të Gaztë dhe të Lëndës së Ngurtë Pezull nga Motorët me Ndezje Pozitive dhe Ata me Ndezje me Kompresion që Djegin Gaz Natyror apo të Lëngshëm për Përdorim në Automjete”
VKM Nr. 352, datë 29.4.2015	“Për Vlerësimin e Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe Kërkesat për Disa Ndotës në Lidhje me të”
VKM Nr. 268, datë 27.4.2023	“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 247, datë 30.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”;
Udhëzime dhe Rregullore	
Udhëzimi Nr. 1037/1, datë 12.04.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore
Udhëzimi Nr. 8, datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre.
Urdhërit Nr. 153 Prot, datë: 25.11.2019	“Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data: 01.01.2020”;
Direktivat :	
Direktiva 2009/28/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 23.04.2009,	“Per promovimin e perdorimit te energjise nga burimet e rinovueshme,si dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE”, të ndryshuar, direktive kjo me objekt të qartë dhe detyra të përcaktuara për të gjitha vendet e BE-se dhe atyre që aderojnë për në BE, për një zhvillim intensiv deri në vitin 2030 dhe atë perspektiv deri në vitin 2050;
Baza ligjore e ndërtimit dhe shfrytëzimit	
Ligji nr. 125/2013,	“Per koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar
Ligji nr.77/2015,	“Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.125/2013 “Per koncesionet dhe partneritetin publik privat””;
Ligjit nr. 107/2014,	“Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar;
Ligjit nr. nr.8318,datë 01.04.1998,	”Per dhenien me qira te tokes bujqesore,pyjore,te livadheve dhe kullotave qe jane pasuri shteterore”,te ndryshuar;
Ligjit nr.7/2018,	“Mbi disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.43/2015 “Per sektorin e energjise elektrike””;
Ligji nr.10 081, datë 23.02.2009	”Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet ne Republiken e Shqiperise”.

➤ Direktivat EU :

- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) “Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën”.
- Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave te Planeve dhe Programeve te Caktuara mbi Mjedisin.
- Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.

- Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pb në ajër.
- Directive 2008/98/EC e Parlamentit Europian 19 November 2008 per mbetjet.
- Decision 2000/532/EC per klasifikimin e mbetjeve (lista e mbetjeve).
- Regulation (EC) No 1013/2006 of the European Parliament and of the Council of 14 June 2006 on dergimin e mbetjeve.
- Direktiva 75/439/KEE mbi Heqjen e Vajrave te mbetura;
- Direktiva 2000/76/KE mbi Djegien e Mbetjeve;
- Direktiva 96/59/KE mbi Heqjen e PCB/PCT;
- Direktiva 94/62/KE mbi Paketimin e Mbetjeve;
- Direktiva 86/278/KEE mbi Llumrat e kanalizimeve.

2.3 Standartet Internacionale te Rekomanduara

Udhëzimet WBG (Grupi i Bankës Botërore, 2008) EHS për Termocentralet:

Udhëzimet e WBG EHS për Termocentralet përcaktojnë informacionin përkatës që duhet të merret parasysh në vlerësimet e ndikimit mjedisor dhe social të proceseve të djegies të nxitura nga gazrat, të lëngët dhe lëndë djegëse fosile të ngurta dhe biomasa dhe të dizajnuara për të dhënë energji elektrike ose mekanike, avull, nxehtësi ose ndonjë kombinimi i tyre, pavarësisht nga lloji i karburantit, me një kapacitet total të vlerësuar të nxehtësisë mbi 50 MW termike input (MWth) në bazë të vlerës së lartë të ngrohjes. Çështjet kryesore të mbuluara përfshijnë:

- **Mjedisi:**
 - Emetimet në ajër;
 - Eficienca e Energjisë dhe Emetimet e GS;
 - Konsumi i ujit dhe ndryshimi i habitateve ujore;
 - Efluentet;
 - Mbetjet e ngurta;
 - Materiali dhe vaji i rrezikshëm;
 - Zhurma.
- **Shëndeti dhe Siguria në Punë:**
 - Rrezatimi jojonizues;
 - Nxehtësia;
 - Zhurma;
 - Hapësira të kufizuara;
 - Rreziqet elektrike;
 - Rreziqet nga zjarri dhe shpërthimi;
 - Rreziqet kimike; dhe
 - Pluhuri.
 - Shëndeti dhe Siguria në Komunitet
 - Konsumit të ujit; dhe
 - Siguria në komunikacion.
- Udhëzimet për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë e WBG **për linajt e Transmetimit të Energjisë Elektrike** dhe Shpërndarja (Grupi i Bankës Botërore, 2007b)

Udhëzimet e WBG EHS për Transmetimin dhe Shpërndarjen e Energjisë Elektrike përcakton informacionin përkatës që duhet të merret parasysh në vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social të linjave të transmetimit ndërmjet një objekti të prodhimit dhe një nënstacioni i vendosur brenda një rrjeti elektrik. Çështjet kryesore të mbuluara përfshijnë:

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e së drejtës së kalimit dhe ndikimet në habitatet tokësore;

- Fushat elektrike dhe magnetike;
- Zhurma;
- Materialet e rrezikshme; dhe
- Shëndeti dhe siguria në punë.

3. TE DHENA TEKNIKE MBI PROJEKTIN

3.1 Qellimi i Projektit.Pershkrim i Pergjithshem i Projektit Teknik

Qëllimi i këtij projekti është të përshkruajë karakteristikat kryesore të Impiant-it Energjistik me Cikël të Kombinuar me kapacitet 170 MW. Projekti i **Termocentralit të Ciklit të Kombinuar / Combined Cycle Power Plant (CCPP)** që do të zhvillohet, ngrihet dhe operohet nga Investitori në zonen e Roskovec-it, Shqipëri.

CCPP do të projektohet për 25 vjet funksionim, duke përdorur makineritë dhe teknologjitë më të fundit të kohës për të arritur efikasitet të lartë dhe për të reduktuar në minimum ndikimin mjedisor.

Energjia elektrike do të dërgohet në Rrjetin Kombëtar të Transmetimit nepermjet nje nënstacioni komutues gazi te izoluar (GIS) do të instalohet në zonën e CCPP.

Projekti CCGT do të jetë një termocentral me cikël të kombinuar me gaz natyror. Furnizimi dhe burimi i gazit natyror i ALBANIA CCGT është tashmë plotësisht i mbrojtur për shkak të marrëveshjes së nënshkruar, ne Shkurti 2022, midis GEK TERNA (në emër të ALBANIA CCGT) dhe Korporatës Publike të Gazit të Greqisë (DEPA) për furnizimin nga Korporata Publike e Gazit të Greqia tek Albania/Shqipëria CCGT rreth 2,0 TW/vit gaz për një periudhë prej të paktën shtatë (7) vjetësh, e dorëzuar në Pikën e Ndërlidhjes ABV31 të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) në ROSKOVEC, sipas kushteve te tregut dhe kontrates.

Impianti i Ciklit të Kombinuar do të furnizojë rrjetin me energji elektrike, i destinuar për funksionimin e vazhdueshëm të ngarkesës bazë në një cikël të thjeshtë, përkatësisht funksionimi i ciklit të kombinuar në shumicën e kohës së vitit.

Impianti përbëhet nga dy turbina me gaz me gaz natyror SGT-800, dy depozita me presion të trefishtë të tipit HRSG dhe një turbinë avulli me kasë të dyfishtë tipi SST-700/900 me një hyrje për avull HP, një hyrje për avull IP dhe një hyrje për avull LP . Avulli i gjeneruar në HRSG lidhet me kokat e zakonshme të avullit që furnizojnë ST (Steam Turbine) me avull. Shkarkimi ST është i lidhur me një kondensator ftohes me ajër. Sistemi i anashkalimit të gazit të shkarkimit midis GT (gas Turbine) dhe HRSG lejon funksionimin e thjeshtë me cikël të çdo GT.

Impianti mund të funksionojë vazhdimisht brenda një game të gjerë ngarkesash që korrespondojnë me 30 – 100% të prodhimit elektrik të impiantit. Në ngarkesën e impiantit nën 50% një GT&HRSG ndalet. GT operohet me rreth 55% ngarkesë GT për ngarkesën minimale të impiantit prej 30% në funksionimin 1x1. Çdo GT operohet normalisht brenda 40 – 100% të ngarkesës së tij të plotë në mënyrë që të arrihet një interval i vazhdueshëm operimi i impiantit brenda 30 – 100%.

4. PERSHKRIMI I VENDODHJES SE PARKUT ENERGJITIK

4.1 Pershkrim i Pergjithshem i Zones se Projektit

Vendodhja e propjektit te propozuar shtirhet ne një zonë rurale , pjese administrative e Bashkise Roskoves, Qarku Fier.

Ajo gjendet e distancuar rreth 3 km ne vije ajrore larg qytetit te Roskovecit , rreth 1 km ne vije ajrore larg fshatrave Jagodine dhe Suk i Siperem (Suk1).

Zona e projektit gjendet prane prane lendes se pare ,gazit natyror i cili do te sigurohet nga tubacionit i trasmetimit te gazit (TAP) dhe qe gjendet 200- 250 m larg perimerit te zones se propozar te projektit te ndertimit te ketij impianti energjitik me cikel te kombinuar , ku si lende e pare djegese do perdoret gaz i lengshem natyror.

Zona Gjeografike: Bashkia e re Roskovec kufizohet në veri dhe perëndim me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Mallakastër, në lindje me bashkinë Ura Vajgurore, ndërsa në perëndim me bashkinë Patos. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Roskovecit.

Bashkia e re e Roskovecit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos-Marinzë, e cila njihet si burimi më i madh i naftës në Europën kontinentale. Pjesë e bashkisë së re do të jetë komuna Kurjan, e cila përfshin edhe fshatin Marinzë, që njihet veçanërisht si zonë naftëmbajtëse. Në këto kushte edhe të ardhurat kryesore të banorëve vijnë nga ky sektor, në të cilin janë punësuar shumë prej banorëve të zonës. Gjithashtu, njësitë e tregtimit dhe shërbimeve janë një tjetër sektor ku janë punësuar shumë prej banorëve të qytetit të Roskovecit. Sa i takon zonave rurale, të ardhurat fitohen kryesisht nga prodhimet bujqësore dhe agrumet .




Figure 4-1:Harta topografike e zones se propozuar te projektit

4.1.1 Koordinatat dhe sipërfaqja e zones se projektit

Sipërfaqja totale e zones se projektit është si më poshtë:

$$S_{\text{totale}} = 41,601 \text{ m}^2 = 4.16 \text{ ha}$$

Koordinatat e zones se projektit janë dhënë në tabelën më poshtë:

Koordinatat e zones sipas 3 projeksioneve hartografike							
	Gauss-Kruger		KRGJSH		UTM		
	E/X	N/Y	E/X	N/Y	E/X	N/Y	
A	4389555.129	4515438.371	473859.173	4514528.518	389468.753	4513501.504	
B	4389739.146	4515664.009	474040.579	4514756.205	389652.695	4513727.05	
C	4389933.252	4515475.652	474236.79	4514570.101	389846.722	4513538.77	
D	4389933.275	4515463.043	474236.957	4514557.495	389846.745	4513526.167	

Figure 4-2: Koordinatat e zones se projektit

4.2 Informacionin për qendrat e banuara në zonën e projektit

4.2.1 Njësia vendore administrative e zonës së projekti

Zona e projektit bën pjesë në bashkinë Roskovec .




Figure 4-3: Njësia administrative të zones se projektit

Të dhëna të përgjithshme mbi bashkinë e zones se projektit jepen si vijon:

Qarku	Fier
Qendra e Bashkisë	Qyteti Roskovec
Popullsia sipas Census 2011	21,742

Popullsia sipas Regjistrir Civil	31,548
Sipërfaqja KM²	118.01
Njësitë administrative përbërëse	
Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Roskovec	Qyteti Roskovec, Fshatrat; Jagodinë
Kuman	Fshatrat; Kuman, Marinëz, Vidhishtë, Luar
Kurjan	Fshatrat; Kurjan, Mbërs, Ngjeqan, Vlosh
Strum	Fshatrat; Strum, Arapaj, Suk 1, Suk 2 , Velmish

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re Roskovec ka 21.742 banorë ndërsa në Regjistrin Civil popullsia e regjistruar figuron 31.548 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 118.01 km². Në bazë të popullsisë së numëruar nga censusi, densiteti i popullsisë së bashkisë së re është 184 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrir civil densiteti rezulton 263.33 banorë/ km².

Pavarësisht burimeve ekonomike, përgjatë dekadave të fundit zona ka pasur një fluks të ndjeshëm largimi të popullsisë. Mund të përmendim këtu zonën e fshatit Ngjeqar, në të cilin sot kanë mbetur një numër shumë i vogël banorësh. Qyteti i Roskovecit ka përfituar disa projekte publike të financuara nga qeveria qendrore gjatë viteve të fundit për zhvillimin e infrastrukturës rrugore brenda qytetit, si dhe për ndërtimin e shkollave dhe qendrave shëndetësore.



Figure 4-4: Njesia administrative Roskovec

4.2.2 Distanca e zonës së projektit nga qendrat e banuara

Zona e projektit është e distancuar nga qendra e banuara. Prane zones së projektit nuk ndodhen shtëpi banimi apo objekte social kulturore. Zona e projektit është e distancuar nga qendra me e afert e banuar njesia administrative Sukth2 rreth 965 m larg ne vije ajrore, nga njesia administrative Jagodine rreth 815 m larg ne vije ajrore, nga Nj.Ad. Sukth 1 rreth 2.7 km ne vije ajrore dhe nga bashkia Roskovec rreth 2.67 km larg ne vije ajrore, nga Nj.Ad. Marinez rrethg 2.6 km ne vije ajrore , nga Nj.Ad.Strum rreth 2.7 km larg ne vije ajrore.



Figure 4-5: Distanca e zonës së projektit nga qendrat e banuara

4.2.2.1 Institucionet Publike dhe Arsimore referuar zones se projektit

Ne afersi me zonen e projektit nuk gjenden institucionet publike apo arsimore qe do ndikoheshin nga ndertimi apo operimi i TEC .

Objektet arsimore me te afërta gjenden te distancuara nga zona e projektit si vijon:

- Shkolla ne Jagodine : rreth 1.59 km ne vije ajrore nga zona e projektit
- Shkollat ne Roskovec : rreth 3.2 km ne vije ajrore nga zona e projektit
- Shkollat ne Suk i Poshtem : rreth 1.44 km ne vije ajrore nga zona e projektit
- Institucionet publike ne Strum dhe Roskovec respektivisht nga 4.1 dhe 3 kma ne vije ajrore nga zona e projektit .




Figure 4-6: Institucionet Publike dhe Arsimore referuar zones se projektit

4.2.3 Trashegimia kulturore ne zonen e projektit

Ne zonen e projektit dhe ne afersi me te nuk gjenden objekte te trashegimise kulturore te cilat do ndikoheshin nga faza ndertimore apo gjate operimit te impiantit. Ne vijim po paraqesim objektet e rendesishme te trashegimise kulturore te qarkut te Fierit. Sic vihet re ne bashkine Roskoves nuk eshte evidentuar ndonje objekt i trashegimise kulturore.

Tabela 4-1: Ne vijim po paraqesim objektet e rendesishme te trashegimise kulturore te qarkut te Fierit

FR001	Kalaja e Margëlliçit	Kategoria: I	Vendi: Margellic Bashkia: Fier	Koordinatat
FR002	Kulla e Pingut (Fier)	Kategoria: I	Vendi: Ndërnenas Bashkia: Fier	
FR003	Banesa e Ferro Fetahut	Kategoria: I Tipologjia: Shtëpi Fusha: Arkitekture	Vendi: Cakran Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.710622 Gatësia: 19.483056
FR004	Banesa e Qerim e Ethem Goxhaj	Kategoria: I	Vendi: Lapulec Bashkia: Fier	
FR005	Banesa e Langareve (Kryegjatë)	Kategoria: I Tipologjia: Banesë Fusha: Arkitekture	Vendi: Kryegjate Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.710622 Gatësia: 19.483056
FR006	Banesa e ish Muzeut Etnografik (Fier)	Kategoria: I Tipologjia: Banesë Fusha: Arkitekture	Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.726736 Gatësia: 19.558164
FR007	Diga e parë dhe e dytë (Kraps)	Kategoria: I Tipologjia: Ndërtim antik Fusha: Arkitekture	Vendi: Kraps Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.654283 Gatësia: 19.600444
FR008	Ikonostasi i kishës së Shën Gjergjit (Fier)	Kategoria: I	Bashkia: Fier Qarku: Fier	
FR009	Kalaja e Gurzezës	Kategoria: I Tipologjia: Kala Fusha: Arkitekture	Vendi: Cakran Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.608372 Gatësia: 19.635092
FR010	Kisha e Shën Premtes (Hoxharë)	Kategoria: I Tipologjia: Kishë e tipit sallë Fusha: Arkitekture	Vendi: Sop Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.713611 Gatësia: 19.408333
FR011	Kisha e Shën Gjergjit (Libofshë)	Kategoria: I Tipologjia: Kishë e tipit sallë Fusha: Arkitekture	Vendi: Libofshë Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.828944 Gatësia: 19.567953
FR012	Kisha e Shën Gjergjit (Strumë)	Kategoria: I	Vendi: Strume Bashkia: Fier	
FR013	Kisha e Shën Kollit (Kurjan)	Kategoria: I	Vendi: Kurjan Bashkia: Fier	
FR014	Kisha e Shën Kollit (Vanaj)	Kategoria: I Tipologjia: Kishë e tipit sallë Fusha: Arkitekture	Vendi: Vanaj Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.844217 Gatësia: 19.573344

FR015	Kisha e Shën Kozmait (Kolkondas)	Kategoria: I Tipologjia: Kishë e tipit sallë Fusha: Arkitekture	Vendi:Kolkondas Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.803061 Gatësia: 19.543439
FR016	Manastiri i Shën Marisë (Pojan)	Kategoria: I Tipologjia: Kompleks monastik me kishen e shen marise ne qender dhe kapela e shen dhimitrit ne anen veriore te saj, arkitektira bizantine. Ne anen jugore te rrethimit ndodhet kembanarja. Fusha: Arkitekture	Vendi: Pojan Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.43461 Gatësia: 19.302
FR017	Mozaiku në fshatin Levan	Kategoria: I	Vendi:Levan Bashkia: Fier Qarku:Fier	
FR018	Mozaiku në fshatin Libofshë	Kategoria: I	Vendi: Libofshë Bashkia: Fier	
FR019	Ndërtesa e ish Qendrës së Organizatës Bashkimi	Kategoria: I	Bashkia: Fier	
FR020	Nekropoli në fshatin Kryegjatë	Kategoria: I Tipologjia: Nekropol Fusha: Arkitekture	Vendi:Kryegjate Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.715956 Gatësia: 19.485564
FR021	Parku Arkeologjik i Apollonisë	Kategoria: I Tipologjia: Park arkeologjik Fusha: Arkeologji dhe arkitekture	Vendi: Pojan Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.363614 Gatësia: 19.38075
FR022	Qyteza e Cakranit (Fier)	Kategoria: I Tipologjia: Vendbanim Fusha: Arkitekture	Vendi: Cakran Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.610039 Gatësia: 19.633542
FR023	Rrënojat e fermës romake Vila Rustika	Kategoria: I Tipologjia: Qytet antik Fusha: Arkitekture	Vendi:Plyk Bashkia:Fier	Gjerësi: 40.667781 Gatësia: 19.574767
FR024	Tempulli antik në fshatin Shtyllas	Kategoria: I Tipologjia:Tempull Fusha: Arkitekture	Vendi: Shtyllas Bashkia: Fier	Gjerësi: 40.707778 Gatësia: 19.4675
FR025	Vendbanimi prehistorik në Cakran (Fier)	Kategoria: I	Vendi: Cakran Bashkia: Fier	



Figure 4-7:Vendodhjet e monumenteve te kultures (pikat me te verdha) perreth zones se projektit(rrethi i kuq)
 Zona e projektit eshte 3.3 m larg monumentit me te afert te kulturës (Ikonostasi i Kishes se Shen Gjergjit) ne lidhje me zonen e projektit dhe me shume se 10 km larg Kishes se Shen Kollit ne Kurjan.



Figure 4-8:Kishes se Shen Kollit ne Kurjan.

4.3 Biodiversiteti ne zonen e projektit

Toka bujqesore e cila eshte shpronesuar dhe aktualisht prone e FTE eshte mbjelle me pare kryesisht me bime foragjere dhe bime are (drithera). Aktualisht e gjithë siperfaqja e projektit ka qene mbjelle me jonxhe dhe grure.

Nga analiza e fitimeve qe realizon nje fermer nga te mbjellat, vleresohet ne rastin me te mire nese toka do te punohet rregullisht dhe mbillet dy here ne vit nje fitim vjetor prej 1 dollare/ m2 ne vit.



Figure 4-9:Ortofoto e vendodhjes se impiantit









Figure 4-10:Foto nga bimesia e zones se projektit

4.4 Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij

Zona e projektit gjendet ne afersi me burimet ujore sipërfaqesore ,Lumin Seman dhe konkretisht rreth 890 m larg ne distance ajrore nga bregu i lumit.

Nderkoh burimet e tjera ujore sipërfaqesore ne afersi me zonen e projektit jane kryesisht kanale drenazhimi dhe ujembledhesa te vegjel. Burimet ujore sipërfaqesore me prane zones se projektit jane :Kanali kullues SUK i poshtem ,Lumi Seman dhe Kolektori i Roskovecit.




Figure 4-11:Burimet ujore sipërfaqesore prane zones se projektit

Keneta e Zeze Strum , ndodhet e distancuar nga zona e projektit rreth 3.14 km ne vije ajrore nderkoh qe rezervuari i Roskovecit ndodhet edhe me larg , 3.5 km ne vije ajrore nga perimetri i gjurmes se projektit.

Kanali vadites i Hoxhares (kolektori i Roskovecit) eshte rreth 758 m larg ne vije ajrore nga perimetri i zones se projektit.

Semani është lumi i dytë për nga gjatësia në Shqipëri, pas Drinit. Lumi fillon në rrethin e Beratit dhe formohet nga bashkimi i dy lumenjve Osum dhe Devoll në afërsi të fshatit Kozarë. Është i gjatë rreth 281 km me pellg ujëmbledhës 5'649km² dhe lartësi mesatare mbi nivelin e detit 863 m. Pasi përshkruan fushën e Myzeqesë, shkarkon ujërat e tij në detin Adriatik, në jug të lagunës së Karavastasë.

Përpara se të arrijë detin ai bashkohet me lumin e Gjanicës i cili përshkon përmes qytetin e Fierit. Duke marrë në konsideratë kushtet hidrometeorologjike, ujëmbledhësi i Semanit është më i varfëri nga të gjithë lumenjtë e Shqipërisë, lidhur me ujërat nëntokësorë. Gjithashtu, rreshjet janë të pakta, mesatarisht 1'084 mm/vit. Prurja mesatare shumëvjeçare është 95,7m³/s. Reth 60% e ujit sigurohet nga ujëmbledhësi i Devollit.

Ujëmbledhësi i Semanit përbëhet nga fusha bujqësore me mbulesë të pakët bimore që i nënshtrohet një erozioni të madh. Sasia e lëndëve të ngurta që transportohen për në det nga Semani është afërsisht 31,2 milionë tonë/vit. Ujërat kanë mineralizim relativisht të lartë prej 440 mg/l. Temperaturat e ujit luhaten nga 6,8o C në janar deri në 25,5oC në gusht. Shtrati i lumit është i pasur me zhavorr dhe rërë të imët, me gjerësi nga 100 deri 200 m. Lumi ka gjithmonë ujë të bollshëm, por me rrjedhje relativisht të ngadaltë. Brigjet janë argjilore të veshura me drurë plepi ose shelgje.

4.5 Përshkrim i Zonave të Mbrojtura, Monumentet e Natyrës dhe Objektet e Trashëgimisë Kulturore

4.5.1 Zonat e Mbrojtura dhe Monumentet e Natyrës

Rrjeti i Zonave të Mbrojtura, brenda Shqipërisë, përmban disa kategori, të cilat mund të përcaktohen si më poshtë:

- Kategoria I: Rezerva Vetëm për qëllime Natyrore/ Rezerva për qëllime Shkencore
- Kategoria II: Park Kombëtar
- Kategoria III: Monument Natyror
- Kategoria IV: Rezerva Natyrore të Administruara/Zonë e Administruar e Specieve dhe Habitave
- Kategoria V: Zonë Peisazhi e Mbrojtur
- Kategoria VI: Zonë e Mbrojtur për Shumë Përdorime.

Me VKM-në nr. 187, datë 25.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 303, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së rishikuar të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare", janë shpallur gjithsej 721 monumente natyre.

Tabela 4-2: Baza e të dhënave e përditësuar e monumenteve të natyrës

Nr.	Qarku	Bashkia	Numri i Monumenteve të Natyrës
1	Fier	Fier	4
		Lushnjë	5
		Divjakë	9
		Patos	3

		Mallakastër	13
	Totali		34

Sic vihet re nuk gjendet asnje monument natyre ne bashkine Roskovec apo ne zonen e propozuar per zhvillimin e ketij projekti.

Në vijim po japim hartën e zonave të mbrojtura në rajonin e Fierit .

Monumentet e Natyres me prane zones se projektit :

- Selvite e Manastirit (Ardenice)
- Rrapi i Zonjes Bubullime



Figure 4-12:Selvite e Manastirit et Ardenices Rrapi i Zonjes Bubullime

Rrapi i Zonjes Bubullime ndodhet ne mes te fshatit ne “ lagjen e Bardhenjeve “ dhe mendohet te jete mbi 200 vjecar.

Ne vijim po prezantojme hartën e zonave te mbrojtura ku perfshihen monumentet e kultures dhe te natyres qe ndodhen brenda zones se projektit






Figure 4-13:Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyres referuar gjurmes se projektit




Pylli i kurorës Adriatik 16 km larg

Figure 4-14: Monumentet e natyres referuar gjurmes se projektit



Rrapi i Zonjes Bubullime



Pylli i Ardenices



Figure 4-15: Monumentet e natyres referuar gjurmes se projektit (gjurma e projektit rrethi me te kuqe)

Konkluzionet:

Sic vihet re, zona e projektit është e distancuar nga Zonat e Mbrojtura dhe monumentet e natyrës. Ndertimi dhe zhvillimi i këtij projekti nuk impakton asnjë nga zonat e mbrojtura apo monumentet e natyrës as në fazë ndërtimore as në atë operacionale.

Zona e projektit është e distancuar nga monumenti më i afërt i natyrës me rreth 6.8 km larg (Rrapi i Zonjës Bubullime) dhe rreth 10 km larg Selvite e manastirit Ardenice.

4.6 Interferenca e Zones se Projektit me Aktivitetet Minerare

Zona e propozuar e projektit nuk interferon asnjë nga zonat e propozuara për aktivitet mineral apo aktualisht në shfrytëzim.

Gjithësesi zona e propozuar e instalimit të TEC nuk ka paraqitur interes për kërkim apo zhvillim të hidrokarbureve. Zona e projektit gjendet pranë tubacionit të shpërndarjes së gazesjellesit të TAP, e cila favorizon zhvillimin e këtij TEC.




Figure 4-16: Zonat minerare referuar zones se projektit

Rajoni ku propozohet të zhvillohet projektin njihet për aktivitetin e shfrytëzimit të hidrokarbureve, veçanërisht zona e Patos- Marinzes por edhe Roskoveci. Në vijim janë treguar vendodhjet më të rëndësishme të hidrokarbureve me pranë zones se projekti, të cilat janë rreth 2.6, 3 km në vijë ajrore ndaj zones se propozuar të projektit.



Figure 4-17:Zonat hidrokarbure prane zones se projektit

4.7 Infrastruktura rrugore prane zones se projektit

Zona e propozuar e projektit gjendet prane rrjetit egzistues te infrastruktures rrugore lokale por edhe asaj kombetare.Kjo favorizon ndertimin dhe operimin e TEC si dhe lehteson qarkullimin e mjeteve, burimeve njerezore , transportin e materialeve per ne impiantin e TEC.



Figure 4-18: Rrjeti rrugor lokal dhe kombetar ne lidhje me zonen e propozuar te projektit

4.8 Cilësia e ajrit urban

Zona e propozuar e projektit është larg zonave të banuara, larg institucioneve arsimore apo publike por relativisht pranë zonave të shfrytëzimit të hidrokarbureve Marineze, Kallmet, Jagodine në të cilën për mëse 50 vitesh është një nga rajonet më të rëndësishme të kërkimit dhe zhvillimit të industrisë hidrokarbure në Shqipëri.

Në zonen e propozuar për ndërtimin e TEC, aktualisht është një zonë rurale por pranë zonave industriale të zhvillimit të hidrokarbureve.

4.9 Mbetjet bashkiake

Grumbullimi, transferimi dhe trajtimi i mbetjeve vlerësohet se përfaqëson mbi 70% të gjenerimit të tyre në nivel bashkie përveçse i përket mbetjeve bashkiake.

Bashkia Roskovec i dërgon mbetjet e gjeneruara urbane nga territori i saj për në incineratorin e mbetjeve urbane në Fier.

Të dhënat për bashkitë bazohen mbi vetëdeklarimin e tyre.

Tabela 4-3: Bashkitë dhe impiantet e depozitimit përfundimtar të mbetjeve

Impianti rajonal (sipas zonës së mbetjeve)	Dërgojnë mbetjet në Incinerator ose Landfill sanitar	Dërgojnë mbetjet në vend depozitime të thjeshta
Incinerator (sipas zonës së mbetjeve)		
Fier (Incinerator) Qarku Fier	Finalizuar. Në pritje marrja në dorëzim e veprës	23. Fier 24. Lushnje 25. Divjakë 26. Patos 27. Roskovec 28. Mallakastër

4.9.1 Forcat shtytëse, presionet, reagimi, ndikimi

Rritja e konsumit, zhvillimi industrial, turizmi janë forca shtytëse që çojnë në rritjen e gjenerimit të mbetjeve. Gjenerimi i mbetjeve urbane, industriale dhe të rrezikshme janë tregues i presionit. Mosmenaxhimi i duhur i mbetjeve është një nga presionet që i ushtrohet mjedisit duke sjellë pasojë negative në mjedis dhe shëndetin e njerëzve. Mbetjet kur hidhen në mënyrë të parregullt, paraqesin rrezik serioz mjedisor për shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe të gjitha gjallesave. Hedhja e mbetjeve pranë lumenjve ka ndikim negativ në cilësinë e ujërave të lumenjve si dhe të trupave ujorë pritës. Ndikimi kryesor i hedhjes së plastikës në mjedis, është se duhen shumë vite që ato të shpërbëhen. Përveç kësaj, nëse mbeturinat plastike digjen, ato lëshojnë një substancë toksike në ajër, duke shkaktuar ndotjen e ajrit dhe si pasojë efekte negative në shëndetin e njerëzve. Sasia e mbetjeve urbane të depozituara në landfill sanitar/incinerator është tregues i reagimit dhe lidhet me masat e duhura për mirëmenaxhimin e mbetjeve.

Një menaxhim i integruar i mirë i mbetjeve nënkupton proceset që përfshijnë përdorimin e burimeve të mbetjeve në mënyrë më eficiente dhe me një ndikim sa më të vogël mbi mjedisin. Për këtë bashkitë të cilat janë ofruesit e shërbimit të pastrimit për komunitetin si edhe gjithë operatorët e licencuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) me ndikim në mjedis, u kërkohet që menaxhimin e mbetjeve ta kryejnë sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit. Menaxhimi i mbetjeve në mënyrë të përgjegjshëm ndaj mjedisit nënkupton ndërmarrjen e të gjithë hapave praktikë për të siguruar që mbetjet menaxhohen në mënyrë të tillë, që të mbrohet shëndeti i njerëzve dhe mjedisit prej ndikimeve negative që shkaktojnë mbetjet. Këto procese përfshijnë:

- menaxhimin e mbledhjes së rrymave të ndryshme të mbetjeve, duke zbatuar hierarkinë e mbetjeve;
 - vënien në dispozicion të komunitetit të infrastrukturës për mbledhjen, ndarjen, riciklimin, rikuperimin dhe depozitimin e mbetjeve;
 - sigurimin e paisjeve me leje të posaçme dhe përmbushjen e kërkesave bazë sipas Lejes mjedisore të dhënë / lëshuar nga AKM si edhe monitorimi dhe zbatimi me rigozitet i kushteve të lejes;
 - dërgimin e mbetjeve vetëm tek pikat e autorizuara;
 - raportimin periodik pranë AKM sipas kuadrit ligjor dhe kushteve të lejes së dhënë;
 - kryerjen e inspektimit mjedisor nga ana e AKM për respektimin e kushteve të lejes dhe kuadrit ligjor përkatës për bashkitë dhe qytetarët;
 - rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit të të gjithë aktorëve të përfshirë në menaxhimin e mbetjeve për të qënë më miqësorë ndaj mjedisit.
- Ndotja nga Kimikatete

Vlerësimi i gjendjes³

³ RAPORTI I GJENDJES NË MJEDIS 2021(AKM)

Tabela 4-4:Gjendja e kimikateve në subjekte të ndryshme

Nr.	Subjekti	Lloji i kimikateve	Sasia	Situata/kushtet.
1	Uzina e Plehrave Azotike, Fier	Kimikate Karbonat kaliumi	10 ton 50 ton	Ambalazuar në bidona Am- balazhuar në thaës (pjesër- isht të çarë)
	Albpetrol sh.a., Fier	Cianur Kaliumi Cianur bakri Nitrat kaliumi Oksid plumbi Hekzametafosfat kaliumi Bikromat kaliumi Sulfat kaliumi etj.	390 kg 920kg 1225kg 200kg 8448 kg 4150 kg 1380kg Në total: 116 ton	Ambalazhet prej çeliku të koroduara, thasët pjesërisht të çarë

Tabela 4-5:Magazinat e kimikateve në vend, lloji i kimikateve që ato kanë të depozituar

Magazinat e kimikateve të vjetra	Përbërja e kimikateve dhe mbetjeve	Sasia (e përafërt) në Kg
Azotiku Fier	Acid formik, V2O5, TS 605, potasium karbonate	93,300

Burimi:Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035

Tabela 4-6:Pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri

Pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri	Sasia potenciale e mbetjeve që ato kanë të depozituara	Përshkrimi i gjendjes
Uzina e azotikut Fier	850 m ³ solucione të mbetura nga prodhimitaria e uzinës	Potencialisht toka dhe ujrat nëntokësorë janë të ndotura me përmbajtje arseniku, të cilat derdhen në tubacionet e ujit të pijshëm apo shkarkohen në rrjedhën e lumenjve.

Rekomandime :

- Rehabilitimi i zonave të nxehta mjedisore (hotspot);
- Reduktimi i përdorimit të kimikateve në bujqësi dhe zhvillimi i bujqësisë organike
- Menaxhimi dhe asgjësimi i duhur i kimikateve laboratorike të papërdorshme për të shmangur magazinimin e tyre.
- Përdorimi i teknologjive më të mira në dispozicion nga sektori i industrisë për uljen e sasisë të kimikateve që gjenerojnë gjatë proceseve teknologjike

5. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS. MASAT PARANDALUESE PER ZBUTJEN E NDIKIMIT

5.1 Permbledhje e Ndikimeve Potenciale

5.1.1 Faza ndertimore & Operacionale e Projektit

- Tjetërsim në përdorimin e tokës
- Biodiversitet
- Ndikim ne cilesine e ajrit
- Emetime zhurmash dhe vibrime
- Ndikimi Social-Ekonomik i Projektit
- Impakti visual
- Impakti ne trashegimine kulturore dhe arkeologjike
- Impakti ndaj shendetit human
- Ndikim ne konsumin e burimeve natyrore
- Ndikim ne burimet ujore
- Gjenerim mbetjesh
- Trafiku

5.1.1.1 Ndryshim I destinacionit te perdorimit te tokes

Toka e propozuar per zhvillimin e ketij projektit perdorej vetem per qëllime agrobujqesore nga ana e fermereve ish pronare te truallit . Tashme toka eshte blere nga zhvilluesit e ketij projekti dhe eshte ne pronesi te tyre. Sipërfaqja e tokes qe do tjetersohet nga ndërtimi i impiantit : **S = 41,601 m² = 4.16 ha** .

5.1.1.2 Ndikimi në Biodiversitetin e Zonës

Faza Ndertimore:

Pastrim /demtim I vegjetacionit egzistues (kulturat bujqesore /bimet e kultivuara foragjere/bime are)

Aktualisht sipërfaqja e tokes e planifikuar per ndertimin e TEC perdorej vetem per qëllime agrobujqesore ,mbjellje me drithera dhe foragjere nga ana e ish pronereve /fermereve . Ndertimi dhe operimi i TEC nuk do impaktoje asnje specie apo bimesi me status te rendesishem apo te listes se kuqe.

Faza Operacionale :

Emetimi ne ajer nga faza operacionale e projektit nuk pritet te ndikojë ne bimesine perreth zones se projektit, pasi nuk ka emetime te grimcave te nguyrta apo kimikate te tjera te cilat potencialisht do impaktonte cilesine e biodiversitetit te zones.

Prodhimi i energjise elektrike nga djegia e gazit natyror konsiderohet si projektet me te pastra ne lidhje me shkakrimet ne mjedis , pasi vete CO2 do shkarkohej ne atmosfer gjate fazes operacionale.

5.1.1.3 Ndikim ne cilesine e ajrit

Faza ndertimore:

Emetime te grimcave te ngurta ne ajer dhe gazeve te emetuara nga djegia e lendeve djegese te nga makinerite ,automjetet qe operojne gjate fazes ndertimore.

- Emetime në ajër të grimcave të pluhurit nga punimet ndërtimore(TSP, PM10,PM2.5)
- Emetime të gazeve nga djegia e lëndës djegëse të automjeteve, makinerive qe operojnë në kantier (CO2, SO2, VOC, NOX) ;

Faza Operacionale e TEC:

Emetimet me te rendesishme per shkak te operimit te TEC do jene emetimet ne ajer gjate fazës se operimit (afatgjate0.

Tabela 5-1: Bilanci i shkarkimeve ne ajër (prurja ne mase)

Te dhena te gazit te shkarkimeve		
Masa	Referuar ajrit me lageshtire	Referuar ajrit te thate
	137.928 kg/sek	130.382 kg/sek

Tabela 5-2: Perbërja e gazrave te shkarkimeve

Përbërja e gazrave te shkarkimeve/ % ne peshe									
Nr	Gazi	Me lageshtire		Ajit te thate		Me lageshtire		Ajit te thate	
1	CO2	6.0224	Wt %	6.370962	Wt %	8.306576	Kg/sek	8.306585	Kg/sek
2	N2	73.3195	Wt %	77.56305	Wt %	101.1281	Kg/sek	101.1282	Kg/sek
3	H2O	5.471	Wt %		Wt %	7.546041	Kg/sek	0	Kg/sek
4	O2	13.9419		14.74882	Wt %	19.22978	Kg/sek	19.2298	Kg/sek
5	Ar	1.2451	Wt %	1.317163	Wt %	1.717342	Kg/sek	1.717343	Kg/sek

Bazuar në këto të dhëna në kg për sekondë, ne mund të llogarisim sasite totale të ndryshme vjetore për 2 x GT (d.m.th. të gjithë TEC):

- Skenari A: 5.500 orë me ngarkesë bazë (100% ngarkesë) në vit: 7.556 ton/vit NOx ; 12.392 ton/vit CO2

- Skenari B: 3.500 orë me ngarkesë bazë (100% ngarkesë) në vit: 4.808 ton/vit NOx ; 7.886 ton/vit CO2

5.1.1.4 Emetime te Zhurmave

Faza ndertimore :

Emetime nga makineritë e transportit të lendeve të para etj;

- Transporti i makinerive pajisjeve të cilat gjenerojnë zhurma dhe vibrime të cilat vlerësohen ne baze te sasise se tyre dhe jane te matshme.
- Emetime zhurma e vibrime nga punimet ndërtimore për instalimin e makinerive , pajisjeve dhe faciliteteve të TEC;

Faza Operacionale :

- Emetime zhurma &Vibrime nga operacionet gjatë fazës operacionale te TEC.

Burimet kryesore të zhurmës gjate fazes operacionale:

- Burimet kryesore të zhurmës gjatë funksionimit të TEC janë:
- Kondensuesi i ftohësi me ajër (ACC) ose kulla ftohëse,
- Gjeneratori i turbinës me avull (STG),
- Kutia e filtrit tek hyrja e dhomes së djegies
- Gjeneratori i avullit të rikuperimit të nxehtësisë (HRSG).

5.1.1.5 Ndikimi Social-Ekonomik i Projektit

Nga ndertimi dhe operimi i ketij TEC ,priten ndikime ne komunitet qe lidhen kryesisht :

- 1- Numri i fermereve te cileve ju perkiste toka e propozuar per zhvillimin e ketij projekti ishte 8.Toka tashme eshte blere nga zhvilluesi i projektit dhe eshte ne pronesi te tyre.

Faza Operacionale:

Zhvillimi i këtij projekt shoqerohet me efekte pozitive sociale si vijon:

- Energjia e prodhuar konsiderohet si energji me emetimet me te vogla krahasuar me cdo TEC tjeter qe perdor si lende djegese qymyr, nafte.
- Krijon vende pune te konsiderueshme afatgjate gjate shfrytezimit te TEC , cila ndihmon ekonominë e vendit dhe rajonit.
- Punësimi i përkohshem dhe afatgjate për komunitetin i cili do të marrë pjesë drejtpërdrejt në proceset e operimit gjë e cila do të sjellë një kontribut të dobishëm në të ardhurat familjare (hapja e vendeve të punës);
- Rritje të ardhurash për shërbimet shtesë që do të duhet të behen për punonjësit që do te merren me operimin e TEC.
- Përmirëson cilësinë e jetës së komunitetit në afërsi me impiantin pasi siguron qendrueshmeri ne punësimin dhe te ardhurat e jeteses.
- Siguron te ardhura nga taksat vendore te cilat perkthehen ne shërbime shtese per komunitetin

5.1.1.6 Impakti visual

Faza ndertimore

Gjate fazes se ndertimit dhe montimit, demtime te perkoheshme do te ndikojne negativisht ne paisazh (psh, prania e grumbujve me dhe, inerte apo materiale te ndertimit)dhe ne relievin e tokes direkt ne terrenit e implementimit te projektit per cdo zone. Ky ndikim do te jete i perkohshem .

Ndikimi ne paisazh I fazes ndertimore eshte kryesisht I perkohshem persa I perket por edhe I perhershëm persa I perket pamjes vizuale qe mbetet pas montimit te instalimeve te TEC .

Faza operacionale

Operimi i TEC do kete nje impakt te perhershëm vizual ne zonen e projektit. Ky impakt nuk konsiderohet i rëndësishëm pasi përreth zones se propozuar te projektit nuk ka elemente te vecante me rëndësi paisazhi , apo monumente te kultures , natyres , vlera dhe rëndësia e te cilave do impaktohej nga ndertimi dhe operimi i TEC.

Impakti ne paisazh ne fazen operacionale do minimizohet me masat parandaluese dhe rehabilituesse te rekomanduara,dhe ky ndikim konsiderohet jo i rëndësishëm.

5.1.1.7 Impakti ne trashëgimine kulturore dhe arkeologjike

Faza Ndertimore:

Gjate fazes ndertimore nuk pritet te ndikohet ne trashëgimine kulturore dhe arkeologjike . Nese gjate punimeve ne terren mund te zbulohen apo identifikohen objekte me vlera te rëndësishme arkeologjike te pazbuluara me pare ,zbatohen kerkesat e ligjin nr. 9048 me date 07.04.2003 “Per trashëgimine kulturore” ndryshuar me ligjin Nr 9885 date28.02.2008 “Për trashëgiminë kulturore” (I azhornuar) .

Faza operacionale:

Nuk pritet te kemi ndikim ne fazen operacionale ,pasi objektet e trashëgimise kulturore jane distancuara nga Zona e projektit dhe te evidentuara.

5.1.1.8 Impakti ndaj shendetit human

Faza Ndertimore :

Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet gjate veprimtarive ndertimore, duhet te kihen parasysh dhe te respektohen rregullat e punes qe percaktohen per veprimtarite ndertimore sipas legjislacionit perkates .

Faza Operacionale:

Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet e ne mjedis te veprimtarive operacionale, te cilat mund te lindin gjate operacioneve te ndryshme te punes duhet te kene parasysh dhe te respektoj kerkesat ligjore per sigurine ne pune.

Kompania do duhet te hartoje vleresim rreziku dhe masa parandaluse per sigurine ne pune konform rregulave te legjislacionit refertuar industrise energjitike.Plani i menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune si dhe trajnimet respektive mbi sigurine dhe shendetin ne pune.

5.1.1.9 Ndikim ne konsumin e burimeve natyrore

Faza ndertimore:

Konsumi i burimeve natyrore gjate fazes ndertimore nuk konsiderohet i rëndësishëm pasi ka te beje kryesisht me konsumin e lendeve te para per ndertimin e faciliteteve te impiantit , lende ndertimi , materiale te gatshme pajisje dhe makineri per operimin e TEC.

Faza Operacionale:

Per nevoja te TEC do kemi konsum te burimeve ujore te cilat do sigurohen nepermjet puseve qe do hapen prane zones se projektit .

Burimi kryesor për ujin e kërkuar për funksionimin e TEC janë puset lokale ose rrjeti i qytetit që mundeson furnizimi me një rrjedhë të mjaftueshme të ujit të papërpunuar në TEC.

Konsumi vjetor i ujit të pa trajtuar është rreth 8000 m³.

Konsumi mesatar i ujit të pa trajtuar është rreth 2.0 m³/h.

Riperdorimi i ujit ftohes te impiantit per qellime pastrimi brenda faciliteteve te TEC do reduktoje konsumin e burimeve ujore dhe perdorimin eficient te tij .

5.1.1.10 Ndikim ne burimet ujore

Gjate fazes ndertimore

Pritet te kemi rritje te nivelit te grimcave te ngurta ne ujerat grumbulluese te shirave te cilat do shkarkohen ne kanalet kulluese ne afersi me zonen e projektit.

Ujrat e zeza te gjeneruara nga punonjesit qe do operrojen si ne fazen ndetimore ashtu edhe ne fazen operacionale jane idikatore qe do duhet te monitorohen per te mos ndikuar ne ujrat siperfaqesore (referoju masave zbutese te rekomanduara).

Faza Operacionale:

TEC nuk do të prodhojë mbetje të lëngshme të rrezikshme, megjithatë potencialisht do kemi rrjedha të caktuara të mbetjeve të lëngshme te cilat do kërkojnë trajtim përpara se të shkarkohen në burimet ujore pritesë:

Rrjedhat e mbetjeve që do të trajtohen përfshijnë:

- Ujërat potencialisht te kontaminuara nga rrjedhjet pikimet nga tubacionet , instalimet që mund të kontaminohen do të mblidhen dhe do të dërgohen në një ndarës/ trajtim përpara se të shkarkohen ne ujrat pritesë
- Ujërat që mund të kontaminohen me kimikate do të mblidhen dhe do të dërgohen në ujërat e impiantit te trajtimit;
- Efluentët e lëngshëm do të shkarkohen në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza;
- Efluentet nga impianti i trajtimit të ujit (fabrika e ujit të demineralizuar) do të shkarkohen në

impianti i trajtimit të ujërave të zeza;

- Zonat ku ruhen vajrat dhe kimikatet do të bashkohen dhe derdhen në një gropë operative të ujërave të zeza për trajtim para shkarkimit në ujra siperfaqesore
- Uji i larjes së kompresorit do të mblidhet në një rezervuar të dedikuar dhe më pas do të shkakrohen ne ujrat pritesë.

Kontraktori do të jetë përgjegjës për trajtimin e ujrave te shkarkimit. Keto perfshijne :

- Impianti i trajtimit të ujit të papërpunuar
- Impianti i demineralizimit dhe dezinfektimit për të prodhuar ujë shërbimi dhe ujë të pijshëm , nëse është e nevojshme.
- Sistemi i ujit të pijshëm për objektin.

- Sistemi i trajtimit të ujit të demineralizuar, duke përfshirë impiantin e trajtimit të ujit, depozitimin, pompimin dhe shpërndarja nëse është e nevojshme.
- Sistemi i ujërave të zeza, duke përfshirë trajtimin, ruajtjen, monitorimin dhe asgjësimin e efluentëve/mbeturinave ujë nga objekti.

Ujrat ftohese te impiantit TEC do te riperdoren per qellime industriale ose per ujra larese . Masat mbrojtese duhen marre per trajtimin dhe monitrimin e cilesise se ujrave te shkarkimit te cfardolloji qofshin ato perpara se ato te shkarkohen ne ujrat sipërfaqesore.

5.1.1.11 Gjenerim mbetjesh

Faza ndertimore:

Mbetjet e ngurta nga faza ndertimore do grumbullohen dhe menaxhohen sipas llojit , kryesisht mbetje urbane dhe inerte nga punimet e fazes ndertimore.

Faza operacionale:

Termocentrali me gaz natyror nuk do të prodhojë mbetje të ngurta si hiri ose llumra (te tilla siç krijohen në një TEC qymyrguri) . Mbetjet e ngurta të prodhuara do të jenë minimale dhe në përgjithësi do të jenë si rezultat i aktiviteteve të mirëmbajtjes ose mbajtjes, të cilat mund të përfshijnë artikuj të tillë si:

- Tuba të vjetra, çeliku, kablo, instrumente etj., të zëvendësuara për shkak të riparimeve ose modifikimeve;
- Artikujt e konsumueshëm p.sh. filtra vaji dhe ajri; dhe
- Artikujt e mirëmbajtjes, p.sh. lecka, enë për bojëra ose kimikate etj

➤ Substancat e rrezikshme dhe toksike:

Përdorimi i substancave të rrezikshme në termocentral është i kufizuar në kimikatet e përdorura në mirëmbajtjen e përgjithshme të impiantit. Të gjitha kimikatet dhe substancat e rrezikshme do duhet të ruhen në vende të sigurta në vend dhe materialet e mbeturinave do të ruhen transportuar nga vendi për ne subjektet e licensuara të asgjësimit të kimikateve.

5.1.1.12 Trafiku

Faza ndertimore:

Gjate fazes ndertimore te TEC , instalimit te makinerive dhe pajisjeve perkohesisht do kemi rrithe te nivelit te trafikut ne rruget e qarkullimit te mjeteve te transportit.Mqs zona e projektit eshte e distancuar nga zona urbane dhe rajoni ne afersi nuk ka trafik te dendur , ky ndikim do jete i perkohshem dhe i miremenaxhueshem me zbatimin e masave te rekomanduara per zbutjen e ndikimit.

Faza operacionale:

Gjate fazes operacionale nuk pritet te kemi nje ndikim te shtuar ne trafik ne rrjetin rrugor pasi nevojat per materile dhe transport gjet kesaj faze jane te limituara vetem per qellime mirembajtje dhe transporti te fuqise punetore .

Lenda e pare e cila gjendet fare prane zones se projektit dhe merret me tubacion , ka eliminuar ne menyre te ndjeshme rritjen e trafikut per shkak te transportit te lendes se pare qe do kishte ne nje rast tjeter biznesi ku do duhej te transportohej lende e pare. Nevojat per transport gjate fazes operationale konsiderohen jo te rendesishme dhe ky ndikim konsiderohet jo sinjifikativ gjithashtu.

6. PËRSHKRIM I SHKURTËR MBI SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, SI DHE PRODHIMIN E MBETJEVE

6.1 Shkarkimet ne ajer

- Faza ndertimore:

Emetime te grimcave te ngurta ne ajer dhe gazeve te emetuara nga djegia e lendeve djegese te nga makinerite ,automjetet qe operojne gjate fazws ndwrtimore.Keto jane vleresuar si emetime te perkohshme nga burime jo stacionare dhe me masa zbutese parandaluese qe do rekomandohen jane te menaxhueshme dhe jo te rendesishme.

- Faza Operacionale e TEC:

Emetimet me te rendesishme per shkak te operimit te TEC do jene emetimet ne ajer gjate fazës se operimit.Keto jane vleresuar si emetime te perhershme (gjate periudhes se funksionimit te TEC) nga burime stacionare.Sasia dhe perberja e ketyre emetimeve konsiderohet e matshme dhe mund te monitorohet ne menyre te vazhdueshme nga operatori .Eshte vleresuar qe keto emetime te jene brenda normave te shkarkimeve ne ajer referuar industrise energjitike (nga djegia e gazit te lengshem natyror).

Tabela 5-3: Bilanci i shkarkimeve ne ajër (prurja ne mase)

Te dhena te gazit te shkarkimeve		
	Referuar ajrit me lageshtire	Referuar ajrit te thate
Masa	137.928 kg/sek	130.382 kg/sek

Tabela 5-4:Perbërja e gazrave te shkarkimeve

Përbërja e gazrave te shkarkimeve/ % ne peshe									
Nr	Gazi	Me lageshtire		Ajit te thate		Me lageshtire		Ajit te thate	
1	CO2	6.0224	Wt %	6.370962	Wt %	8.306576	Kg/sek	8.306585	Kg/sek
2	N2	73.3195	Wt %	77.56305	Wt %	101.1281	Kg/sek	101.1282	Kg/sek
3	H2O	5.471	Wt %		Wt %	7.546041	Kg/sek	0	Kg/sek
4	O2	13.9419		14.74882	Wt %	19.22978	Kg/sek	19.2298	Kg/sek
5	Ar	1.2451	Wt %	1.317163	Wt %	1.717342	Kg/sek	1.717343	Kg/sek

Bazuar në këto të dhëna në kg për sekondë, ne mund të llogarisim sasite totale të ndryshme vjetore për 2 x GT (d.m.th. të gjithë TEC):

- Skenari A: 5.500 orë me ngarkesë bazë (100% ngarkesë) në vit: 7.556 ton/vit NOx ; 12.392 ton/vit CO2

- Skenari B: 3.500 orë me ngarkesë bazë (100% ngarkesë) në vit: 4.808 ton/vit NOx ; 7.886 ton/vit CO2

6.2 Mbetjet e gjeneruara

- Mbetjet e ngurta nga faza ndertimore

Faza operacionale:

Termocentrali me gaz natyror nuk do të prodhojë mbetje të ngurta si hiri ose llumra (te tilla siç krijohen në një TEC qymyrguri) . Mbetjet e ngurta të prodhuara do të jenë minimale dhe në përgjithësi do të jenë si rezultat i aktiviteteve të mirëmbajtjes ose mbajtjes, të cilat mund të përfshijnë artikuj të tillë si:

- Tuba të vjetra, çeliku, kablo, instrumente etj., të zëvendësuara për shkak të riparimeve ose modifikimeve;
- Artikujt e konsumueshëm p.sh. filtra vaji dhe ajri; dhe
- Artikujt e mirëmbajtjes, p.sh. lecka, enë për bojëra ose kimikate etj

Aty ku është e mundur, artikujt do të riciklohen. Përndryshe, mbetjet e ngurta do të grumbullohen dhe trajtohen në deponimin e mbetjeve të qytetit nepermjet subjekteve te licencuara .

- Substancat e rrezikshme dhe toksike:

Përdorimi i substancave të rrezikshme në termocentral është i kufizuar në kimikatet e përdorura në mirëmbajtjen e përgjithshme te impiantit. Të gjitha kimikatet dhe substancat e rrezikshme do të ruhen në vende të sigurta në vend dhe materialet e mbeturinave do të ruhen transportuar nga vendi për ne subjektet e licensuara te asgjësimit të kimikateve.

6.3 Ujërat e ndotura dhe shkarkimet

Termocentrali nuk do të prodhojë mbetje të lëngshme të rrezikshme, megjithatë potencialisht do kemi rrjedha të caktuara të mbetjeve të lëngshme te cilat do kërkojnë trajtim përpara se të shkarkohen në burimet ujore pritese:

Rrjedhat e mbetjeve që do të trajtohen përfshijnë:

- Ujërat potencialisht te kontaminuara nga rrjedhjet pikimet nga tubacionet , instalimet që mund të kontaminohen do të mblidhen dhe do të dërgohen në një ndarës/ trajtim përpara se të shkarkohen ne ujsat pritese
- Ujërat që mund të kontaminohen me kimikate do të mblidhen dhe do të dërgohen në ujërat e impiantit te trajtimit;
- Efluentët e lëngshëm do të shkarkohen në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza;
- Efluentet nga impianti i trajtimit të ujit (fabrika e ujit të demineralizuar) do të shkarkohen në impianti i trajtimit të ujërave të zeza;
- Zonat ku ruhen vajrat dhe kimikatet do të bashkohen dhe derdhen në një gropë operative të ujërave të zeza për trajtim para shkarkimit në ujra sipërfaqesore
- Uji i larjes së kompresorit do të mblidhet në një rezervuar të dedikuar dhe më pas do të shkarkohen ne ujrart pritese.

6.4 Emetime Zhurma

Lidhur me emetimin e zhurmave gjatë fazës ndërtimore, duhet theksuar se ky ndikim është i përkohshëm. Së pari faza e ndërtimit është fazë jo afatgjate dhe së dyti operacionet e ndërtimit do të

kryhen brenda orareve të zakonshëm të punës. Gjithsesi zona e interesit e projektit është e distancuar mjaftueshëm nga zonat urbane (referoju kapitulli Distanca e zonës së projektit nga qendrat e banuara)

Nderkoh edhe gjate fazes operacionale do kemi emetime te zhurmave ne zonen rreth projektit por qe nuk pritet te ndikohet ne zonat e banuara pasi jane te distancuara.

Burimet kryesore të zhurmës gjate fazes operacionale:

Burimet kryesore të zhurmës gjatë funksionimit të TEC janë:

- kondensuesi i ftohesi me ajër (ACC) ose kulla ftohëse,
- gjeneratori i turbinës me avull (STG),
- Kutia e filtrit tek hyrjea e dhomes së djegies
- gjeneratori i avullit të rikuperimit të nxehtësisë (HRSG).

Gjatë startimit te procesit, tubacioni i avullit me presion të lartë dhe kondensuesi jane burimet kryesore te zhurmës, me avullin që anashkalon gjeneratorin e turbinës (STG). Turbina me djegie dhe gjeneratori (CTG) zakonisht vendosen duke siguruar mbyllje akustike, duke ulur kështu nivelin e emetimit të zhurmës. Kjo nuk do të thotë që pajisjet e tjera të bilancit të impiantit (BOP balance of plant) nuk gjenerojnë zhurmë dhe mund të shpërfillen.

Efektet kumulative të kompresorëve të gazit, të kompresorit të ajrit, pompave të furnizimit me ujë të bojlerit, ftohësve me vaj lubrikues dhe pajisjeve të tjera mund të kenë gjithashtu një efekt kumulative në nivelet e zhurmës. Por këto janë pjesë më të vogla të pajisjeve dhe përgjithësisht më të lehta për t'u riparuar me zbutjen akustike.

ACC ose kulla ftohëse, në varësi të disponueshmërisë së ujit në vend, është një burim kryesor zhurme .Për një ACC, emetimi i zhurmës është kryesisht për shkak të ventilatoreve /elikeve dhe përhapja është një shqetësim për shkak të lartësisë së lartë të ventilatorit mbi tokë. Në nisjen e procesit ,perdoren me shume ventilatore per te patur nje efekt më të madh të kondensimit. Për një kullë ftohëse, zhurmat emetohen nga vetilatoret /elikat , por zhurma e rënies së ujit është mbizotëruese. Për të dyja, opsionet e zbutjes përfshijnë përzgjedhjen e ventilatorit (elika më të mëdhenj, me rrotullim më të ngadaltë), muret e barrierave akustike të kuvertës së ventilatorit dhe pengesat akustike të hyrjes së ajrit, ndër të tjera.

STG. Një tjetër burim i madh i zhurmës, STG, në fakt përbëhet nga burime të shumta: turbina me avull, gjeneratori, kondensuesi dhe pompat e kondensatës. Turbina me avull dhe gjeneratori zakonisht vijnë nga prodhuesi me mbyllje akustike(kapake reduktues zhurme).




Figure 5-1: Turbina me avull dhe gjeneratori (STG) i inkooporuar ne kapake per reduktimin e zhurmes

Dhoma e filtrit të hyrjes së djegies : Dhoma e filtrit të hyrjes së djegies është një pajisje shumë e zhurmshme me karakteristika të larta drejtimi dhe brezi të gjerë .Nëse pozicionohet drejt receptorëve të ndjeshëm ndaj zhurmës, shpesh është një burim shqetësimi.

Oxhaku i shkarkimit ose HRSG është shpesh burimi i zhurmës gjithashtu.

Silenciatorët vertikalë në oxhak dhe silenciatorët horizontalë brenda HRSG përdoren zakonisht për të zbutur zhurmën e shkaktuar nga vetë rryma e shkarkimit.



Figure 5-2: Silenciatorët vertikalë në oxhak dhe silenciatorët horizontalë brenda HRSG

Gjeneratori i avullit të rikuperimit të nxehtësisë (HRSG). HRSG konsiderohet burimi i emetimit te zhurmës

Ekzistojnë burime të shumta zhurmash brenda termocentraleve me ciklin të kombinuar me gaz (CCPP) që duhet të adresohen në mënyrë që të qëndrojnë nën nivelin maksimal të zhurmës që lejohet të ketë një impiant.

Në CCPP, si termocentralet e thjeshta me cikël, do të gjeni silenciatorë në dalje/shkarkim. Këta silenciatorë quhen pengesa paralele, mbytës absorbues dhe ndonjëherë, ndarës. Ato janë panele silenciatorë që futen në rrugen e kalimit te gazit , paralelisht me rrjedhën. Kanali i sistemit të shkarkimit të sistemit përdoret për të drejtuar shkarkimin e turbinave me gaz përmes një seksioni silenciator dhe grumbullimi në gjeneratorin e avullit të rikuperimit të nxehtësisë (HRSG) të CCPP, duke siguruar efikasitet të shtuar, duke përmbushur kërkesat e emetimeve dhe duke reduktuar zhurmën.

Nuk është aq e zakonshme që të ketë një sasi të konsiderueshme silencatoresh në një CCPP në HRSG sepse zhurma që vjen përmes sistemit dobësohet shumë nga rreshtat aktual të tubave të bojlerit. Kjo zvogëlon nevojën për silencatore kur krahasohet me një cikël të thjeshtë që nuk ka një HRSG për të mbytur zhurmën. Megjithatë, impiantet e mëdha të ciklit të kombinuar kanë turbina të mëdha dhe të zhurmshme, kështu që zakonisht ekziston nevoja për një lloj silenciatori për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret e zhurmës.

Silenciatorët e shkarkimit, si pjesët dhe përbërësit e tjerë CCPP, konsumohen. Kur e bëjnë këtë, është thelbësore që termocentralet të kenë një burim riparimi industrial të besueshëm dhe me përvojë për të zbutur problemin.

6.4.1 Shkarkimet ne toke

Persa i perketë ndotjes së tokës ajo mund të jetë aksidentale nga derdhja e karburanteve që përdorin makineritë dhe mjetet që operojnë në TEC.

Gjatë periudhës së operimit zhvilluesi duhet të marrë në konsideratë masa parandaluese për parandalimin e derdhjeve dhe veprimet që duhet të ndërmerren në rast rrjedhje. Keto masa do të detajohen në fazat e tjera të projektit.

7. INFORMACION PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA

7.1 Kohëzgjatjen e Mundshme e Ndikimeve Negative të Identifikuara

Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.

Pjesa më e madhe e ndikimeve të identifikuara gjatë fazes ndertimore janë të përkohshme. Afati i planifikuar për perfundimin e fazes ndertimore të projektit është parashikuar rreth 1 vite. Ndikimet e fazes operacionale do të jenë afatgjate.

7.1.1 Vlerësimi i Rëndësisë së Ndikimeve Negative Mjedisore

Natyra e ndikimeve mund të kategorizohen në terma të:

- Drejtim (kahjes)- Pozitive apo negative
- Kohëzgjatjes - Afatgjatë apo afat shkurtër
- Vendndodhjes - Direkt ose indirekt
- Magnitudës - E madhe apo e vogël
- Shtrirjes - E gjerë apo lokale
- Rëndësisë - E madhe apo e vogël

Tabela 7-1: Metodika e vlerësimit të rëndësisë së ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Kategoria	Përshkrimi
I ulët	Ndikimi është i përkohshëm, dëmton pak vlera natyrore si në cilësi dhe në sasi (volum). Me përfundimin e operacionit që e shkakton ai nuk jep më efekte në mjedis.
I mesëm	Ndikimi është i përkohshëm por në mungesë të masave kontrolluese dhe menaxhuese mund të shkaktojë ndikime afatgjata në vlerat natyrore. Sipërfaqja që tjetërsohet nuk rikthehet më në gjendjen e saj por zë një raport të pranueshëm me sipërfaqen totale të zonës (koeficienti i tjetërimit) si dhe tjetërsohet vetëm sipërfaqja ndertimore e objektit. Ndikimi nuk përfaqëson shkarkime të ndotësve në mjedis.
I konsiderueshëm	Ndikimi është i përhershëm dhe del përtej zonës së ndikuar (zhvendosje, ndotje, zhurma e shkarkime në ajër). Ndikimi kompromenton normat e shkarkimeve në mjedis dhe normat e përdorimit të mjedisit.
I kthyeshëm	Mbaron efektin me ndalimin e shkakut dhe mjedisi i ndikuar rifiton gjendjen e tij natyrale. Dëmton vlera/zona të mbrojtura dhe unike.
Pjesërisht kthyeshëm	Efekti vazhdon pjesërisht edhe pas ndërprerjes së shkakut që e shkakton atë. (vazhdon efektin negativ në mjedis pjesërisht)
I pakthyeshëm	Pasojat e ndikimit janë të pakthyeshme (vazhdojnë efektin negativ në mjedis) edhe pasi përfundon veprimi që shkakton ndikimin.

Për të identifikuar sistematikisht ndikimet që lidhen me ndërtimin e objektit të propozuar, është ndërtuar një matricë e ndikimit e cila vendos përballë aktivitetet kryesore të projektit kundër faktorëve relevantë mjedisorë.

Tabela 7-2: Pësha , volumi dhe kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar

	Aktiviteti/ Impakti	Drejtimi (kahja)		Kohëzgjatja e ndikimeve			Burim i impaktit		Magnituda			Rëndësia		
		Pozitiv	Negativ	Afat gjate	Afat mesem	Afat shkurter	Direkt	Indirekt	Madhe	Mesme	Vogel	Madhe	mesme	Vogel
A	FAZA NDERTIMORE E TEC													
	Transporti i materialeve për në objekt													
1	Emetime Pluhuri gjate ngarkimit, transportit të materialeve		X			X	X				X			X
2	Emetime te gazeve të makinave të transportit të materialeve;		X			X	X				X			X
3	Rendim i trafikut nga qarkullimi i automjeteve		X			X	X				X			X
B	NDERTIMI I TEC													
1	Zhurma, vibrime		X			X	X				X			X
2	Pluhuri		X			X	X				X			X
3	Tjëtërsim në përdorimin e tokës		X	X			X				X			X
4	Emetime te gazeve të makinerive që operojnë në objekt		X			X	X				X			X
5	Pamja vizuale		X			X	X				X			X
6	Gjenerimi i dherave nga gërmimet		X			X	X				X			X
7	Gjenerimi i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i kompanisë		X			X		X			X			X
8	Gjenerim i mbetjeve inerte		X			X	X				X			X
9	Gjenerimi i ujërave të zeza nga aktiviteti human i kompanisë		X			X		X			X			X
10	Ndotje e tokës si pasojë e avarive të mekanike në zonën e projektit		X			X		X			X			X
11	Impakt në vegjetacion egzistues		X	X				X			X			X
12	Krijimi i vendeve të punës	X				X	X			X			X	
C	FAZA OPERACIONALE TEC													
1	Emetime te gazeve CO2 nga djegia e gazit natyror		X	X				X			X		X	
2	Zhurma, vibrime		X	X				X			X	X		X

	Aktiviteti/ Impakti	Drejtimi (kahja)		Kohëzgjatja e ndikimeve			Burim i impaktit		Magnituda			Rëndësia		
		Pozitiv	Negativ	Afat gjate	Afat mesem	Afat shkurter	Direkt	Indirekt	Madhe	Mesme	Vogel	Madhe	mesme	Vogel
3	Konsum i burimeve natyrore (uje)		X	X				X		X	X		X	
4	Krijimi i vendeve të punës	X		X			X			X		X		
5	Pamja vizuale		X	X				X			X			X
6	Impakt ekonomik (te ardhura lokale kombetare)	X		X				X	X			X		
7	Gjenerim Mbetjesh nga Faza Operacionale		X	X				X			X		X	

8. SHTRIRJA E MUNDSHME HAPËSINORE E NDIKIMEVE NEGATIV NË MJEDIS, QË NËNKUPTON DISTANCËN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QË PËRFSHIHEN NË TË

8.1 Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar

Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.

Per shkak te karakterit te projekti , sipërfaqësisë se sheshit te ndërtimit, referuar proceseve te punës , makinerive dhe pajisjeve qe do perdoren duke zbatuar masat parandaluese , reduktuese dhe rehabilituese te ndikimeve potenciale negative te vlerësuar te sygjeruara per tu zbatuar sipas kësaj VNM , nuk pritet qe impaktet e vlerësuar negative te kenë shtrirje hapësinore përtej zonës se projektit.

Ato jane parashikuar te minimizohen dhe lokalizohen ne sheshin e ndërtimit per fazen ndertimore dhe jane vlersuar jo signifikante ne zonën përreth sheshit te projektit .

Për të përcaktuar më mirë masat për kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative të identifikuar gjatë procesit të VNM, në këtë paragraf është bërë një kategorizim i rëndësisë së çdo ndikimi të mundshëm negativ në mjedis të projektit. Ky kategorizim është kryer bazuar në vlerat mjedisore të zonës, legjislacionin mjedisor në fuqi dhe njohuritë mbi teknologjinë dhe teknikën e kryerjes së operacioneve ndërtimore.

Shtrirja e ndikimeve te identifikuar ne fazen operationale (si ndikime afatgjate dhe me te rendesishme) perfshin zonat ku kalon gjurma e projektit qe i perket bashkkise Roskovec dhe kryesisht zonave me prane zones se projektit si fshtarat Jagodine, Suk dhe Suk i Poshtem si ne harten ne vijim :




Figure 7-1:Fshtarat e ndikuara referuar zones se projektit

Tabela 7-3: Pësha , volumi dhe shtrirja e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara

	Aktiviteti/ Impakti	Drejtimi (kahja)		Burim i impaktit		Magnituda			Shtrirja		Rëndësia		
		Pozitiv	Negativ	Direkt	Indirekt	Madhe	Mesme	Vogel	E Gjerë	Lokale	Madhe	Mesme	Vogel
A	FAZA NDERTIMORE E TEC												
	Transporti i materialeve për në objekt												
1	Emetime Pluhuri gjate ngarkimit, transportit të materialeve		X	X				X		X			X
2	Emetime te gazeve të makinave të transportit të materialeve;		X	X				X		X			X
3	Rendim i trafikut nga qarkullimi i automjeteve		X	X				X		X			X
B	NDERTIMI I TEC												
1	Zhurma, vibrime		X	X				X		X			X
2	Pluhuri		X	X				X		X			X
3	Tjëtërsim në përdorimin e tokës		X	X				X		X			X
4	Emetime te gazeve të makinerive që operojnë në objekt		X	X				X		X			X
5	Pamja vizuale		X	X				X		X			X
6	Gjenerimi i dherave nga gërmimet		X	X				X		X			X
7	Gjenerimi i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i kompanisë		X		X			X		X			X
8	Gjenerim i mbetjeve inerte		X	X				X		X			X
9	Gjenerimi i ujërave të zeza nga aktiviteti human i kompanisë		X		X			X		X			X
10	Ndotje e tokës si pasojë e avarive të mekanike në zonën e projektit		X		X			X		X			X
11	Impakt në vegjetacion egzistues		X	X				X		X			X
12	Krijimi i vendeve të punës	X		X			X			X		X	
C	FAZA OPERACIONALE TEC												
1	Emetime te gazeve CO2 nga djegia e gazit natyror		X	X			X			X	X		
2	Zhurma, vibrime		X	X			X			X		X	
3	Konsum i burimeve natyrore (uje)		X		X		X			X		X	

	Aktiviteti/ Impakti	Drejtimi (kahja)		Burim i impaktit		Magnituda			Shtrirja		Rëndësia		
		Pozitiv	Negativ	Direkt	Indirekt	Madhe	Mesme	Vogel	E Gjerë	Lokale	Madhe	Mesme	Vogel
4	Krijimi i vendeve të punës	X		X			X		X		X		
5	Pamja vizuale		X		X			X		X			X
6	Impakt ekonomik (te ardhura lokale .kombetare)	X			X	X			X		X		
7	Gjenerim Mbetjesh Nga Faza Operacionale		X		X			X		X		X	

9. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR

Mundësinë e Rehabilitimit të Mjedisit të Ndikuar dhe Mundësinë e Kthimit të Sipërfaqes së Mjedisit të Ndikuar në Gjendjen e Mëparshme, Përfshirë edhe Tokën Bujqësore, si dhe Kostot Financiare të Përafërta për Rehabilitimin;

Për shkak se FIER THERMOELECTRIC do duhet të kete një kujdes të vecante për mbrojtjen e mjedisit, dhe të ceshtjeve të sigurisë, do të kryejë aktivitetet në një mënyrë të tillë që të mbrojë mjedisin, punonjësit, klientët dhe publikun e gjerë. Kompania do duhet të zhvillojë aktivitetin në përputhje me ligjet dhe rregulloret për mjedisin dhe sigurinë dhe do të zhvillojë dhe zbatojmë programe për të siguruar pajtueshmërinë me to.

Kompania do të jete përgjegjës në lidhje me ceshtjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, dhe sigurisë së punonjësve. Kompania duhet të bëhet e vetëdijshme se rreziqe për mjedisin nuk janë të trajtuara nga ligjet ose rregulloret ekzistuese, dhe do duhet të zhvillojë metodat bazuar në standartet me të mira, në të dhënat shkencore gjithëpërfshirëse dhe relevante. Kompania do të duhet të bashkëpunojë me publikun, qeverinë, industrinë dhe paleve të interesit për identifikimin e objektivave mjedisore dhe sigurisë si dhe në zhvillimin e programeve efektive të kontrollit.

9.1 Plani i Rehabilitimit Mjedisor

Masat konkrete që do realizohen pasi të demtohet burimi gjenerues në mënyrë që të sigurohet një mbrojtje e kujdeshme e mjedisit përfshirë permisimi i mjedisit pas mbylljes së veprimtarisë.

Në këtë kapitull janë pershkruar masat e propozuara që synojnë reduktimin e ndikimit në mjedis pas ndërprerjes së aktiviteteve në të gjithë instalimin apo në pjesë të ndryshme të tij, duke përfshirë masat për menaxhimin e mbetjeve të mundshme ndotëse, pas mbylljes së instalimit.

Me përfundimin e burimit gjenerues (gazit natyror) do bëhet edhe cmontimi i impiantit energjitik dhe rehabilitimi i zones.

Gjatë cmontimit të impiantit do të kihen në konsideratë masat mbrojtëse të sigurisë në punë por dhe mbrojtja e mjedisit dhe kthimi i sheshit në gjendjen fillestare.

Cmontimi i instalimit lidhet kryesisht me masat për largimin e impiantit nga sheshi i punës i cili përfshin prishjen e objekteve egzistuese, çmontimin e instalimeve, veçimin e mbetjeve inerte të gjeneruara nga prishjet e objekteve, veçimin dhe menaxhimin korrekt të llojeve të tjera të mbetjeve sipas llojit për të mundësuar riciklimin, ripërdorimin e tyre, pastrimin e sheshit të impiantit, largimin e shtresave të inerteve /betonit nga sipërfaqja e tokës dhe në fund rehabilitimi i sipërfaqes së tokës me dhëra vegjetative (nëse do gjendet mundësia për të gjetur dhëra pranë zonës së impiantit), në të kundërt sheshi i impiantit do rekomandohet për zhvillime të tjera biznesi.

1-Cmontimi i impiantit : Cmontimi dhe largimi i instalimeve nga sheshi për në një zonë të caktuar nga zhvilluesi i projektit për ta ripërdorur këtë impiant për qëllime shitje/skrapi

2-Pastrimi i cdo materili inert të mbetur në sheshin e zonës së projektit, pastrimi nga cdo kontaminim i mundshëm për shkak të rrjedhjeve pikimeve.

Gjithe zona ku do jete instaluar impianti do te pershtatet si pjese e infrastruktures se zonës se projektit si shesh i lire per zhvillime te tjera biznesi apo zone zhvillime urbane;

Per largimin e mbetjeve te gjeneruara nga procesi i çmontimit do jene marre masat paraprake per nënshkrimin e kontratave per largimine mbetjeve sipas llojit :

Tabela 9-1: Operacioneve , ne vijim si vijon:

Nr.	Operacioni	Pershkrimi i operacionit
1	Lidhja e kontrates me asgjuesin /trajtuesin perfundimtar te mbetjeve.	Dergimi dhe asgjuesimi final mbetjeve te gjeneruara sipas llojit si dhe plotesimi i dokumentacionit perkates perfundimtar per cdo sasi mbetje te transferuar nga zona e projektit per ne vendodhjen finale te depozitimit apo trajtimit te tyre.
2	Largimi i mbetjeve te gjeneruara nga cmontimet.	Mbledhja dhe transporti i mbetjeve qe do te gjenerohen (mbetje ambalazhimi). Nese do te kete mbetje te rrezikshme, do te menaxhohen me kontraktor dhe transporti i tyre do te kryhet nga nje kompani e licensuar.
3	Rehabilitimi i mjedisit dhe peisazhit	Synimi i kthimit te gjendjes se mjedisit ne gjendjen fillestare. Pastrimi i terrenit, heqja e mbetjeve, rimbjellja me vegjetacion aty ku eshte e mundur nese do gjendet mundesi e permisimit te cilesise se tokes me dhera prane zones se projektit

Tabela 9-2: *Masat për zbutjen e ndikimeve*

Lloji i ndikimit	Masa për zbutjen e ndikimit	Efektshmëria e masave
Faza e cmontimit		
Emëtimet në ajër, si pluhurat	Spërkatja me ujë (veçanërisht në kohë të thatë) të zonës së punës; Makinat te jene te mbuluara gjate transportimit te materialeve inerte	Ul përqëndrimin e grimcave të ngurta në ajër.
Krijimi i zhurmave	Mirëmbahen automjetet e punës; Ndalohet rënia e borive në zonat e banuara; Makinat e transportit dhe pajisjet janë bashkëkohore dhe plotësojnë standardet kombëtare, të pajisura me marmitë selenciatore të pakësimit të zhurmave.	Ul shkallën e bezdisjes që vjen nga prania e zhurmave.
Gjenerim mbetjeve	Për menaxhimin e tyre rekomandohen këto masa: Vecimi I mbetjes sipas llojit Riperdorim , riciklim , trajtim Kompania duhet te nenshkruaje paraprakisht kontrata me grumbulluesit, transportuesit, trajtuesit e mbetjeve sipas llojit ne menyre qe te largoje ato nga sheshi I impiantit per ne depozitimin final ose ne trajtimine tyre final.	Shmang përhapjen e mbetjeve në mjedis, mbron mjedisin dhe shmang impaktin viziv të padëshiruar.

9.1.1 Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e secilës masë të propozuar

Ne vijim po japim ne menyre te permbledhur masat dhe përgjegjesit per realizimin e tyre gjate fazes se cmontimit te instalimit.

Tabela 9-3: *Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e secilës masë të propozuar*

Përmbledhje jo Teknike e VNM-së "Impiant Energjistik me Cikël të Kombinuar" Roskovec, Shqipëri	Page 59 nga 83
---	----------------

Aktiviti/ ndikim qe do te monitorohet?	Ku do te monitorohet?	Si do te monitorohet/tipi i pajisjeve te monitorimit	Kur do te monitorohet? (frekuenca e matjeve ose vijimesia	Pse do te monitorohet parametri? (Opsionale)	Indikatorret	Pergjegjesia per zbatimin
Cmontimi largimi i mjeteve pajisjeve objekteve te kantierit nga zona e punimeve		Inspektim vizualisht	Ne mbyllje te fazes peracionale	Te sigurohet qe zona e ndikuar te lihet ne gjendje te sistemuar dhe paster nga cdo object/makineri		
Largimi i cdo lloj mbetjeve nga kantieri	largimin per tek vendi i depozitimit te cdo lloj mbetje te mbetur ne kantier	Menaxhimi i mbetjeve sipas llojit me nenkontraktore te licensuar per trajtim , riciklim riperdorim apo depozitim final te mbetjeve ne vendet e miratuara nga njesia vendore	Ne mbyllje te aktivitetit	Per te siguruar menaxhim te mire te mbetjeve dhe mos lenien asnje lloj mbetje ne vendin e ndertimit	Sasia e mbetjeve qe do te largohen nga kantieri per ne venddepozitim dhe dokumentat perkatese te transferimit/trajtimit / riciklimit te mbetjes nga nenkontraktoret	Kontraktori i punimeve i zbaton , mbikqyresi i monitoron /kontrollon
Transporti i materialeve te çmontuara dhe mbetjeve te gjeneruara nga çmontimi i impiantit,	Gjate qarkullimit ne rruget automobilistike per ne vend depozitimin final te	vizualisht	Periodikisht gjate çmontimit.	Per te evituar ndotjen e ajrit nga grimcat e pluhurit gjate transportit te lendes se pare.	Kamiona te mbuluara.	Zhvilluesi i projektit

Aktiviti/ ndikim qe do te monitorohet?	Ku do te monitorohet?	Si do te monitorohet/tipi i pajisjeve te monitorimit	Kur do te monitorohet? (frekuenca e matjeve ose vijimesia	Pse do te monitorohet parametri? (Opsionale)	Indikatorret	Pergjegjesia per zbatimin
automjetet e transportit te jene te mbuluar .	materialeve dhe mbetjeve te gjeneruara.					
Shqetesim nga trafikut, ankesa per menaxhimin e trafikut.	Kantier dhe rruget lidhese per ne sheshin e impiantit.	Mbikqyrje vizuale	Periodikisht gjate fazes se cmonitimit	per te siguruar shqetesim minimal nga trafiku i shtuar	Numri i ankesave te marra	Zhvilluesi i projektit
Shqetesime zhurmash	objektet e banimit me te aferta me gjurmën e rrugës nga sheshi i impiantit per ne destinacionin final	Monitorim i nivelit te zhurmave me instrumenta per matje zhurme te kalibruar me ane te laboratoreve te akredituar	Sa here qe vihen re rritje nivele zhurmash prane objekteve te banimit, si dhe sipas kushteve te Lejes se Mjedisit	Per te siguruar nivelet e zhurmave sipas normave te lejuara UDHEZIM (Nr.8, date 27.11.2007) "Per Nivelet Kufi te Zhurmave ne Mjedisite te Caktuara"	Nr i ankesave te regjistruara. Niveli i matjeve te zhurmave ne me laboratoret	Zhvilluesi i projektit
Nivelet e grimcave te ngurta ne ajer	Sheshi i impiantit dhe perreth zones se TEC	Matje e nivelit te grimcave te ngurta ne ajer nepermjet	sipas kushteve te Lejes se Mjedisit	Per te siguruar emetime minimale gjate	Nr i ankesave te regjistruara.	Zhvilluesi i projektit

Aktiviti/ ndikim qe do te monitorohet?	Ku do te monitorohet?	Si do te monitorohet/tipi i pajisjeve te monitorimit	Kur do te monitorohet? (frekuenca e matjeve ose vijimesia	Pse do te monitorohet parametri? (Opsionale)	Indikatorret	Pergjegjesia per zbatimin
		instrumantave mates te kalibruar (PM10;PM2.5;TSP) me ane te laboratoreve te akredituar..		punimeve Brenda nivelit te lejuar sipas VKM nr.803 datë 04.12.2003 "Për normat e cilësisë së ajrit".	Niveli i matjeve te grimcave te ngurta ne ajer ne menyre periodike	
Pajisjen me spill kit dhe mjetet e nevojshme te reagimit ne rast derdhje ,rrjedhjet pikimet e vajrave dhe karburanteve	Sheshi i impiantit dhe perreth zones se TEC	Inspektim , identifikim i rrjedhjeve pikimeve te vajrave , karburantit	Inspektime rutine ne sheshin e impiantit dhe perreth zones se TEC	Te parandaloje kontaminimin e tokes apo ujit nga rrjedhjet aksidentale	Nr i rrjedhjeve te nodhura dhe reagimi ndaj derdhjes (evidence)	Zhvilluesi i projektit
Largimi i mbetjeve nga sheshi i impiantit /TEC per ne depozitimin e miratuar	Ne kantier per mbledhjen ne kohe dhe largimin per tek vendi i depozitimit	Marrje aprovimim nga Njesia vendore per depozitimin e mbetjeve dhe rekordet perkatese te mbjetjeve te transportuara	Sapo gjenerohen nga procesi i shkatërrimit te objekteve dhe çmontimi i instalimeve	Per te siguruar menaxhim te mire te mbetjeve	sasia e mbetjeve qe do te largohen nga sheshi i TEC per ne venddepozitim dhe dokumentat perkatese te transferimit/trajtimit / riciklimit te mbetjes	Zhvilluesi i projektit

9.2 Plani per mbrojtjen e shendetit dhe sigurise se njerezve

9.2.1 Baza Ligjore

Sigurimi tenik nuk është vetëm një detyrim ligjor, por është një çështje mjaft me rëndësi duke qenë se ka lidhje drejtëpërdrejtë me shëndetin e punonjësve. Përmirësimi i tij, parandalimi dhe menaxhimi i risqeve përbën sot një nga sfidat kryesore të aktiviteteve në vendin e punës. Mbrojtja në punë dhe ruajtja e shëndetit të punonjësve në e aktivitet, duhet të jetë në perputhje me zbatimin e rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Kjo rregullore zbatohet në çdo vend pune nga subjektet publike dhe private, që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Ligji Nr.10237 datë 18.2.2010 'Për sigurinë dhe shëndetin në punë'.
- VKM Nr. 563, datë 3.7.2013, Per miratimin e rregullores "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vëndin e punës";
- VKM NR.521, date 6.8.2014 Në adoptimin e rregullores "kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë për pajisjet me ekran shfaqës".
- VKM Nr. 108 datë 09.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotesojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara që merren me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë."
- VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masa të veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë";
- VKM Nr. 639, datë 07.09.2016 "Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë"
- VKM Nr. 788, datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës";
- VKM Nr. 461, datë 22.7.1998 "Për regjistrin që mban punëdhënësi për aksidentet në punë dhe për sëmundjet profesionale";
- VKM. 522, datë 06.08.2014, Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve nga risqet e lidhura me agjentët kimikë në punë";
- VKM 563, datë 03.07.2013 :Për miratimin e rregullores "Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e punëmarrësve lidhur me punën ekrahit me ngarkesa"
- Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier"
- VKM 1012, datë 05.05.2010 "Për sinjalistikën në kantier dhe në vendin e punës";
- VKM. 842, datë 12.03.2014 Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit te punëmarrësve nga risqet e lidhura me zhurmën në vendin e punës";

9.2.2 Vlerësimi i riskut

Para fillimit të çdo pune është e nevojshme të kryhet një Vlerësim Fillestar i Riskut.

Vlerësimet e riskut janë një mënyrë efektive për vlerësimin e rreziqeve të sigurisë dhe shëndetit, mjedisit, si dhe masat e kontrollit që lidhen me qëllimin e punimeve. Vlerësimi i riskut nuk është dokument i pavarur dhe duhet të jetë pjesë (të shoqërojë) detyrat specifike të metodologjisë së punës. Së bashku, këto dy

dokumente detajojnë punimet që duhet të kryhen, rendin dhe mënyrën në të cilën duhet të ndërmerren dhe masat e kontrollit për të menaxhuar në mënyrë efektive rreziqet.

Vlerësimi e riskut duhet të lidhet me qëllimin në metodologjinë e punës, të kontrollohet dhe të diskutohet rregullisht për të parandaluar riskun për dëmtimin e punonjësve. Gjithashtu duhet të shqyrtohet nëse ka ndonjë ndryshim në metodën e punës që mund të rrisë rreziqet.

Vlerësimet e riskut nuk duhet të shkruhen me vete, duhet të shkruhet nga një grup individësh, si p.sh inxhinier, menaxher. Vlerësimi i riskut duhet kryer para përfundimit të metodologjisë së punës.

9.2.3 Punimet në lartësi

Kjo procedurë duhet të zbatohet kur punohet në lartësi, ose kur ekziston rreziku rënia të ndodhë nga një lartësi 1.8-2 metra.

- Nëse do të ketë punime në lartësi kjo duhet të merret parasysh nga kompania për të implementuar të gjitha masat e duhura për minimizimin e risqeve, si dhe të vlerësohet/kontrollohet nga supervizoret.
- Personeli që punon në zonat e ngritura më shumë se 1.8 m mbi nivelin e tokës ose sipërfaqen ngjitur ku ekziston ekspozimi i rënies duhet të përdorin mbrojtjen dytësore të rënies në sigurimin e litarit të sigurisë, në një strukturë, litar shpëtimi ose pajisje të miratuar.
- Pajisjet dhe sistemet e mbrojtjes nga rënia nuk duhet të përdoren për ndonjë qëllim tjetër përveç mbrojtjes së punonjësve.
- Pajisjet mbrojtëse shtesë janë të detyrueshme të përdoren për të gjitha punimet në lartësi mbi 1.8m.
- Duhet të sigurohen mënyra aksesit, siç janë shkallët, për personelin që duhet të kryejë punë në zonat e ngritura.
- Punimet në lartësi duhet të supervizohen për zbatimin e duhur të masave mbrojtëse

9.2.4 Kujdesi mjekësor

Objektivat e programit të kujdesit shëndetësor mjekësor janë për të mbrojtur shëndetin e individëve që punojnë në objekt. Programi përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

- Historia e kaluar mjekësore, duke përfshirë informacion në lidhje me sëmundje të mëparshme, ekspozimet e mëparshme dhe historinë mjekësore personale dhe familjare.
- Një profil mjekësor i cili përfshin ekzaminimin fizik, analizat dhe teste të tjera.
- Kontrolli i detyrueshëm sipas një intervale të caktuar
- Certifikata i aftë për punë për çdo personel
- Vendet e punës duhet të vlerësohen nga mjeku i kompanisë për rrezikshmerinë që mund të paraqesin te punonjësit

Të dhënat mjekësore për çdo individ do të përfshijnë, si minimum:

- Emër/Mbiemër të punonjësit
- Raportet dhe rezultatet e ekzaminimeve dhe testeve;

- Formularin e Deklarimit të Mjekut, të nënshkruar dhe të datajuar nga mjeku ekzaminues ose konsultues;
- Çdo ankesë mjekësore e punonjësve që lidhet me ekspozimin e substancave të rrezikshme;
- Kopjet e rezultateve të monitorimit të ekspozimit të higjienës të punonjësve;

9.2.5 Siguria elektrike

Punimet elektrike për vetë natyrën e rrezikshmërisë të cilën paraqet duhet të kryhen nën kujdesin e vecantë, nga persona të trajnuar dhe certifikuar. Vlerësim specifik i riskut të punimeve elektrike duhet të kryhet para fillimit të cdo pune dhe duhet të supervizohet për të zbatuar të gjitha masat e nevojshme të sigurisë. Pasojat nga mos zbatimi i duhur i masave mbrojtëse mund të shkaktojnë fatalitet te punonjësit e angazhuar dhe ndjekje penale per personat përgjegjës. Hpat më poshtë duhet të zbatohen:

- Vetëm personeli i autorizuar lejohet të kryejë punë të natyrës elektrike.
- Punimet elektrike duhet të jenë të supervizuara
- Personeli të jetë I trajnuar
- Të gjitha materialet dhe pajisjet elektrike duhet kopntrollohen para fillimit të punës nga persona të certifikuar
- Caktimi I afateve periodike të kontrollit të pajisjeve dhe trajnimi I stafit.
- Shkeputja e rrymës elektrike në atë seksion ose departament ku punohet
- Kycja e lidhjes nëpërmjet kycave të sigurisë

9.2.6 Rastet aksidentale, rënia e zjarrit

Rrugët dhe daljet nga zjarri duhet të shënohen në mënyrë adekuate dhe të mbahen të pastra në çdo kohë, veçanërisht nga materialet e djegshme dhe burimet e ndezjes. Dyert e zjarrit duhet të mbahen të mbyllura kur është e përshtatshme dhe asnjëherë të mos hapen.

Sapo një zjarr të marrë një kontroll ai do të vazhdojë të zhvillohet për sa kohë që ka karburant dhe oksigjen për të mbështetur djegien. Kjo është arsyeja pse është kaq e rëndësishme të mos keni materiale të djegshme në rrugët e evakuimit, dhe materiale të djegshme të ruajtura të panevojshme si letër, karton ose plastikë në zyra dhe depo.

Në rast te rënies së zjarreve, në territorin e magazinës është afishuar skema e evakuimit. Mbi bazën e kësaj skeme personeli që ndodhet në magazinë vepron duke bërë njoftimet e PMNZSH në numrat e zjarrfikëseve të afishuar ne tabelat përkatëse. Brenda magazinës funksionon dhe lidhja telefonike dhe telefonat celularë që vihen në dispozicion per lajmërimin e zjarrfikëseve.

Vetitë fiziko-kimike të lëndëve e materialeve në rruajtje dhe përpunim, janë një tregues me ndikim negativ me pasoja të pritshme për rënie të zjarrit.

Ndërtesa e magazinës, është me konstrukcion të padjegshëm. Ajo përbëhet nga dysheme beton arme, kollonat konstrukcion metalik dhe muret anësore me panele sandëich. Në këto kushte zjarri mund të linde dhe të zhvillohet vetëm në lëndët dhe materialet e djegshme që ruhen dhe përpunohen brenda magazinës.

Strukturat ndërtimore të godinës së magazinës janë të padjegshme. Ato l qëndrojnë zjarrit pa u shkatërruar duke l lënë mundësinë personelit të largohen nga ndërtesa por edhe për të asistuar në fikjen e zjarrit me anë të mjeteve zjarrëfikëse të vendosura nëpër magazinë.

9.2.7 Ngritja e peshave në mënyrë manuale

Teknika e dobët e ngritjes shkakton dëmtime të shumta të anëtarëve të stafit çdo vit. Rregulloret e Manualit të Operacioneve të Trajtimit i bëjnë të gjitha operacionet ngritëse objekt vlerësimi. Nëse lëvizni ngarkesa të rënda për ndonjë distancë, gjithmonë përdorni një transportues për të shmangur tendosjen e panevojshme të shpinës. Mos u përpiqni të mbani më shumë sesa mund të menaxhoni me lehtësi. Jini veçanërisht të kujdesshëm kur ngjisni shkallët ndërsa mbani gjëra.

Operacionet e ngritjes mund të jenë veprimtari të rrezikshme nëse nuk janë planifikuar si duhet dhe nuk kryhen në mënyrë të sigurt. Ngritja e sigurt varet nga tre elementë kryesorë, të cilët kërkojnë që operacioni të jetë:

- planifikuar siç duhet nga një person kompetent
- mbikëqyret në mënyrë të përshtatshme
- kryhet në një mënyrë të sigurt

9.2.8 Ndhimja e parë

Ndhimja e parë mund të shpëtojë jetë, të zvogëlojë dhimbjen dhe të ndihmojë një person të dëmtuar të shërohet më shpejt. Rregulloret e Shëndetit dhe Sigurisë kërkojnë nga që të sigurohen pajisje dhe personel të përshtatshëm për të mundësuar dhënien e ndihmës së parë punonjësve tuaj nëse ata janë të dëmtuar ose sëmuren në punë. Dispozita minimale për të gjitha objektet është:

- një kuti e ndihmës së shpejtë me pajisje të mjaftueshme për të përballuar numrin e punëtorëve;
- një person i caktuar për të marrë përgjegjësinë për dhënien e ndihmës së shpejtë
- Informacion që u tregon punëtorëve emrin e personit të caktuar ose ndihmësit të parë dhe ku t'i gjejnë ata.

9.2.9 Substancat e rrezikshme

Çdo substancë e rrezikshme që do të përdoret, ose proceset që mund të prodhojnë materiale të rrezikshme, duhet të identifikohen. Rreziqet nga puna që mund të prekin punonjësit ose anëtarët e publikut duhet të vlerësohen. Projektuesit duhet të eliminojnë materialet e rrezikshme nga planet e tyre. Kur kjo nuk është e mundur, ata duhet të specifikojnë produktet më pak të rrezikshme të cilat performojnë në mënyrë të kënaqshme. Kontraktorët shpesh kanë njohuri të hollësishme të materialeve alternative, më pak të rrezikshme. Projektuesit dhe kontraktorët shpesh mund të ndihmojnë njëri-tjetrin në identifikimin e materialeve dhe proceseve të rrezikshme dhe sugjerimin e alternativave më pak të rrezikshme. Njerëzit mund të jenë të ekspozuar ndaj substancave të rrezikshme ose sepse i trajtojnë ose i përdorin ato drejtpërdrejt. Identifikoni dhe vlerësoni të dy llojet e rrezikut. Nëse substancat e rrezikshme do të

përdoren, prodhuesit dhe furnizuesit e substancave të tilla kanë një detyrë ligjore për të siguruar informacion. Lexoni etiketën në kontejner dhe / ose fletën e të dhënave të sigurisë.

9.2.10 Dëmtimet nga rrëshkitjet

Diçka aq e thjeshtë sa një rrëshkitje është shkaku i vetëm më i madh i lëndimeve në vendet e punës, duke çuar në më shumë se 1000 dëmtime të mëdha që raportohen çdo vit. Shumica e këtyre dëmtimeve mund të shmangen lehtësisht nga menaxhimi efektiv i atyre zonave të vendit ku punëtorët kanë nevojë për qasje, të tilla si korridoret, shtigjet e rrugëve, vendkalimet e shkallëve. Masat për të parandaluar aksidentet:

- Mbani të pastra zonat e punës dhe magazinimit.
- Planifikoni dërgesat për të minimizuar sasinë e materialeve në vend.
- Sigurohuni që korridoret, shkallët, shtigjet e këmbësorëve dhe zonat e tjera të përdorura nga këmbësorët të mbahen larg pengesave në çdo kohë.
- Kur ndryshimet e vogla të nivelit nuk mund të shmangen, (p.sh. hyrjet e dyerve në ndërtesa) merrni parasysh përdorimin e rampave të përkohshme të ndërtuara mirë ose ndonjë mënyrë tjetër për të siguruar një qasje të lehtë dhe të sigurt.
- Përdorni mjete pa tela kur është e mundur për të shmangur nevojën për të menaxhuar funksionimin e kablllove

9.2.11 Sigurimi teknik i objektit

Gjatë ushtrimit të aktivitetit, subjekti është i vetëdijshëm që problemet e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë janë më të rëndësishmet dhe me të mprehta dhe marrin vlerësim parësor në veprimtarinë e përditshme. Në të gjitha operacionet, punësohen specialistë me eksperiencë pune në fushën e aktivitetit që zhvillohet.

Rregulloret e Teknikës së Sigurimit, nga ana e drejtuesit teknik, zbatohen në çdo proces pune të përcaktuar në plan-organizimin e kryerjes së punimeve të hartuara nga drejtuesi teknik, i cili gjithmonë duhet të përmbajë:

- Drejtuesi teknik i punimeve, ose personi i ngarkuar, bën kontrollin teknik dhe azhurnimin e saktë të aktivitetit.

Parandalimi i aksidenteve dhe ngjarjeve, realizohet nëpërmjet:

- a) Instruktimin fillestar të punëmarrësve,
- b) Instruktimi periodik në lidhje me sigurinë në punë,
- c) Trajnimeve dhe testeve në lidhje me aftësinë e njohjes së procesit të punës dhe të makinerive.
- d) Pajisja me materialet e nevojshme për të vepruar në rast aksidenti/emergjence,
- e) Përdorimi i detyrueshëm i pajisjeve mbrojtëse personale si dhe pajisjeve mbrojtëse kolektive në vendet e punës. Implementimin në departamentet përkatëse të kompanisë, të një procedure për rastet e aksidenteve dhe ngjarjeve si dhe trajtimin mjekësor të tyre nëpërmjet shërbimit të stafit mjekësor.

9.2.12 Plani i emergjencave

Plani i emergjencave është një ndër planet kryesore që duhet të ketë hartuar kompania para fillimit të punimeve të cmontimit. Plani i emergjencave ka për qëllim ruajtjen e shëndetit të punonjësve, komunitetit dhe mjedisit ku nëpërmjet njohjes dhe zbatimit të tij arrihet shmangia e aksidenteve në frontin e punës ose menaxhimi i shpejtë i tyre.

Personeli i këtij aktiviteti duhet të njohë mirë të gjitha proceset që kryhen në këtë projekt në mënyrë që të arrijë të kuptojë situatën, shkaqet dhe të jetë i përgatitur për menaxhimin e avarisë apo aksidentit. Gjithashtu pas hartimit të planit të emergjencave, trajnimet duhet të kryhen për çdo personel si edhe të përcaktohen dhe ndahen detyrat për të gjithë punonjësit e angazhuar në këtë projekt.

Për hartimin e planit të emergjencave, duke filluar që nga fazat fillestare, përgjegjësi i sigurisë duhet të marrë një informacion rreth kushteve të sigurisë nëpërmjet konsultimeve me punëtorët të cilët e njohin vendin e punës dhe faktorët të cilët mund të përbëjnë një rrezik potencial.

Ndarja e detyrave do të realizohet si më poshtë:

Menaxheri i përgjithshëm:

- Përcaktimin e politikave të sigurisë dhe reagimit në rastet e emergjencave
- Caktimin e detyrave dhe përgjegjësive për të gjithë personelin e angazhuar
- Përcaktimin e planit dhe afateve për kontrollin dhe zbatueshmërinë e raportit

Përgjegjësi i sigurisë dhe shëndetit në punë:

- Implementimin dhe zbatueshmërinë e planit dhe politikave të hartuara nga menaxheri
- Investigimet në vendet e punës për zbatimin e kushteve të duhura dhe të sigurta
- Konsultimet dhe trajnimet me punëtorët

Punëtorët:

- Zbatimi i rregullave të sigurisë
- Vlerësimin e riskut potencial në vendet e punës
- Kryerja e detyrave duke marrë parasysh kushte të sigurta pune
- Zbatimi i detyrave të përcaktuara nga menaxhmenti i lartë
- Njohja dhe zbatimi i planit të reagimit ndaj emergjencave
- Ofrimin e ndihmës së parë nga personi i trajnuar për ofrimin e ndihmës së parë
- Reagimin ndaj zjarrit për personat e trajnuar në rastet e rënies së zjarrit

Klasifikimi i rasteve emergjente do të kryhet sipas shkallës së rrezikshmërisë të cilat ato paraqesin duke u bazuar në aktivitetin e zhvilluar. Me poshtë janë paraqitur rastet për reagimet ndaj emergjencave:

- Zjarri

Në rastin e rënies së zjarrit në objekt duhet të jetë i instaluar sistemi i detektimit të zjarrit nëpërmjet sensorëve për tu pasuar me sitemin e alarmit zanor në momentin e detektimit në rastet e mungesës së personelit në objekt. Për menaxhimin e duhur të situatës duhet të jenë të instaluar dhe sistemet automatike të fikjes së zjarrit pas momentit të detektimit ose pas rënies së alarmit nga punonjësit. Gjithashtu i gjithë objekti duhet të jetë i pajisur me fikse zjarri të përshtatura sipas kategorisë së zjarrit. Rekomandohet të përdoren fikse zjarri përkatëse sipas figurës më poshtë.



I gjithë personeli duhet të jetë i trajnuar për të ofruar një reagim të duhur në rastet e rënies së zjarrit. Vetëm personat kompetent dhe të trajnuar duhet të reagojnë për shuarjen e zjarrit, pjesa tjetër e personelit duhet të evakohet në pikat e caktuar nga kompania. Gjithashtu në të njëjtën kohë duhet të kryhet dhe njoftimi i drejtorisë së zjarrfikëses për menaxhimin e duhur të situatës nëpërmjet numrave të telefonisë emergjente.

- Aksidente në punë me pasoje dëmtimin e punonjësve

Në rastet e aksidenteve në punë me pasoja dëmtime në personel duhet të lajmërohet menjëherë përgjegjësi i sigurisë, personi i cili është i trajnuar për ofrimin e ndihmës së parë dhe në rastet më të rënda të lajmërohet urgjenca kombëtare. Kutitë e ndihmës së shpejtë duhet të mirëmbahen dhe të jenë të aksesueshme në çdo kohë nga personat të cilët do të ofrojnë ndihmën e parë. Plani duhet të jetë i mirëpërcaktuar dhe detajuar për menaxhimin dhe reagimin e duhur në kohë si pasojë e rrezikshmërisë dhe seriozitetit të paraqitur.



Trajnimet e personelit duhet të programohen dhe të jetë me intervale të përcaktuara. Më poshtë po listojmë hapat që duhet të ndiqen për reagimin në një situatë emergjente.

- Identifikimi i dëmtimit të shkaktuar dhe rënia e alarmit
- Evakuimi
- Njoftimi i emergjencave kombëtare
- Vlerësimi i situatës
- Dhënia e ndihmës së parë
- Dërgimi në njësitë e specializuara të ndihmës së shpejtë

Vendodhjet e kutisë së ndihmës së shpejtë duhet të jenë të dukshme dhe të shënuara nëpërmjet sinjalistikës së duhur.



- Tërmete

Shqipëria kategorizohet si një vend me frekuencë të lartë për sa i përket rënies së tërmeteve. Si pasojë e kësaj duhet të hartohet një plan i detajuar për reagimet në raste emergjence. Reagimi ndaj tërmeteve fillon që në fazat e para të projektimit të godinës sipas manualit të ndërtimit për rezistencën ndaj tërmeteve. Struktura e godinave të kompanisë është metalike e cila ka një elasticitet të lartë dhe mund të durojnë tërmete me magnitudë më të lartë. Gjatë rënies së tërmetit duhet të merren parasysh masat dhe veprimet si më poshtë:

- Rënia e alarmit
- Ruajtja e qetësisë
- Largimi nga vendet e punës drejt rrugë daljeve të përcaktuara të emergjencës
- Rrugët duhet të mbahen të lira për tu kaluar nga personeli
- Ofrimi i ndihmës për personat invalidë ose gratë shtatzane
- Dyert të jenë funksionale dhe me hapje nga jashtë
- Nuk duhet të krijohen grumbullime njerëzish
- Mbledhja në pikat e grumbullimit të caktuara nga kompania larg godinave dhe objekteve
- **Derdhje aksidentale të likuideve ose materialeve të rrezikshme**

Materialet e magazinuar duhet të ruhen në kushte të vecanta magazinimi duke i ndarë dhe ruajtur sipas kategorisë. Në rastin e materialeve të rrezikshme duhet të tregohet kujdes i vecante gjatë punimeve në afërsi për të mos shkaktuar derdhje aksidentale ose kontakt me lekuren. Të gjitha materialet duhet të jenë të ndara, të shoqëruara dhe të shënuara me të dhënat e sigurisë së materialeve. Trajtimi dhe menaxhimi i materialeve duhet të kryhet sipas kushteve të përcaktuara nga MSDS. Gjatë kontaktit me lekurën ose sytë të materialit duhet të kryhet menjëherë shpëlarja e duarve dhe syve në vendet e caktuara. Në rastet kur iritimi i lekurës është më i lartë atëherë duhet të kryhet një trajtim më i specializuar duke u konsultuar dhe me mjekun e kompanisë.

Gjithashtu kujdes i vecante duhet të tregohet gjatë derdhjeve aksidentale të materialeve të rrezikshme të cilat mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit. Ragimin në rastet e derdhjeve aksidentale duhet të kryhet vetëm nga personat të cilat janë të trajnuar. Duhet të ndiqen hapat me poshte:

- Vlerësim i situatës
- Kufizim i ndotjes
- Rrethimi i zonës dhe përdorimi i spill kit
- Depozitimi i materialit në vendet përkatëse



Figure 9-1: *Spill kit per pastrimin e derdhjeve*

Trajtimi i kimikateve dhe materialeve

- Fleta e të Dhënave të Sigurisë së Materialit (MSDS) duhet të sigurohet për të gjitha kimikatet dhe të mbahet nga oficeri i HSE si dhe të shënohet në vendin e magazinimit.
- Kërkesat e specifikuara në MSDS duhet të plotësohen plotësisht kur përdorni, trajtoni dhe ruani kimikatet.
- MSDS gjithashtu duhet të sigurohet për të gjitha materialet e reja për rishikim dhe aprovim përpara se të blihen dhe përdoren.
- Informacione për sigurinë që duhet të bëhen për ata që trajtojnë kimikate të rrezikshme duke iu referuar atyre përdorimin dhe ruajtjen.
- Një person i caktuar dhe i trajnuar, i cili i njih mirë vetitë e kimikateve, do të jetë përgjegjës për ruajtjen dhe lëshimin e të gjitha kimikateve të rrezikshme.
- Një inventar i të gjitha kimikateve do të mirëmbahet nga oficeri i HSE.

9.2.13 Sinjalistika

Kjo procedurë përshkruan instalimin dhe mirëmbajtjen e barrikadave dhe shenjat paralajmëruese për këtë projekt. Për qëllimin e kësaj procedure, një barrikadë përkufizohet si një sistem për të paralajmëruar një rrezik dhe për të identifikuar fizikisht parametrat e rrezikut.

Ka disa kategori/tipe barrierash

- Barrierat e shiritave (barrikatat e buta) sigurojnë paralajmërim të përkohshëm ose akses të kufizuar dhe nuk duhet të përdoren si mbrojtje anësore.



- Barrierat e ngurta (barrikatat e forta) përdoren për të mbrojtur punonjësit nga ekspozimi ndaj rreziqeve afatgjata, kufizimit dhe / ose mbrojtjes nga rënia. Një barrikadë e ngurtë është një pajisje mbrojtëse prej druri ose metalike, e aftë të përballojë një forcën nga çdo drejtim.



Shenjat (ose etiketat) përdoren në lidhje me barrikatat për të dhënë paralajmërime të veçanta dhe / ose informacione të tjera thelbësore për rrezikun(et) që ekzistojnë përtej barrikadës.

Barrierat dhe shiritat paralajmërues do të sigurohen sipas rastit. Pengesa fikse dhe të forta do të përdoren për mbrojtjen e buzës në gjurmime dhe hapje. Shiritat do të përdoret vetëm si një paralajmërim për rrezik.

Shenjat e paraqitura në këtë procedurë grupohen si më poshtë:

- Ndalimi

- Detyrim
- Paralajmërim
- Gjendje e Sigurtë
- Zjarr

Sinjalistika dhe shiritat e sigurisë duhet të mirëmbahen, dhe zëvendësohen rregullisht kur dëmtohen. Të gjitha daljet emergjente, kalimet, pikat e mbledhjes së emergjencës duhet të theksohen me shenja të gjendjes së sigurisë.

Shenjat e ndalimit do të shfaqen për kufizimin e aksesit ose hyrjes, zonat e duhanit, parkimi dhe çdo akt tjetër i paautorizuar.

Shenjat e detyrueshme duhet të sigurohen për zbatimin e veshjeve dhe pajisjeve personale mbrojtëse dhe sigurimin e udhëzimeve specifike të përshtatshme për detyrën ose gjendjen.

Shenjat e zjarrit duhet të sigurohen në zonat ku janë vendosur pajisjet e zjarrit (p.sh. aparatet për zjarr, hidranti / pikat e zjarrit, batanije zjarri etj.).

Shenjat e ndalimit

Shenjat e ndalimit janë shenja që ndalojnë veprime ose aktivitete të caktuara në zonën (et) e postuara. Ato përdoren për kufizimin e aksesit ose hyrjes, pa zona për pirjen e duhanit, pa parkim dhe veprime të tjera të paautorizuara. Shenjat e ndalimit përbëhen nga një sfond i bardhë dhe një shenjë e zezë në mes të shenjës me një vijë të kuqe mbi të.



Shenjat e detyrueshme

Shenjat e detyrueshme janë shenja që japin udhëzime që duhet të ndiqen në zonën e caktuar. Përdoret për zbatimin e veshjeve dhe pajisjeve personale mbrojtëse dhe sigurimin e udhëzimeve specifike të përshtatshme për detyrën ose gjendjen. Këto shenja përbëhen nga sfondi blu me një shenjë të bardhë në mes.



Shenjat paralajmëruese

Shenjat paralajmëruese janë shenja që japin informacion për të paralajmëruar personelin për kushtet e rrezikshme. Këto shenja përdoren për rreziqe zjarri, pajisje elektrike, punime civile hapje, punë në lartësi, shërbimet, linjat e energjisë elektrike dhe rreziqe të tjera. Shenjat paralajmëruese përbëhen nga një sfond i verdhë me një shenjë të zezë në mes.



Shenjat e gjendjes së sigurtë

Shenjat e gjendjes së sigurtë janë shenja që ofrojnë informata të përgjithshme të sigurisë që kanë të bëjnë me vendin e punës. Këto shenja përdoren për të gjitha daljet emergjente, kalimet, stacionet e ndihmës së parë, dhe pikat e emergjencës. Shenjat e gjendjes së sigurtë përbëhen nga një sfond i gjelbër me një shenjë të bardhë në mes.



Shenjat e zjarrit

Shenjat e zjarrit janë shenja që përshkruajnë vendndodhjen dhe llojet e pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri. Këto shenja përdoren në zonat ku janë vendosur pajisjet e zjarrit (p.sh. aparatet për zjarr, hidrantët / pikat e zjarrit, batanije zjarri etj.). Shenjat e zjarrit përbëhen nga një sfond i kuq me një shenjë të bardhë në mes.



10. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS

10.1 Ndryshim I destinacionit te perdorimit te tokes

Siperfaqja e tokes qe do tjetersohet nga ndërtimi i impiantit **eshte S = 4.16 ha**. Numri i pronareve te cilet aktualisht kane perdorur kete siperfaqe toke per qellime agrobujqesore eshte relativisht i kufizuar , dhe vetem 8.

Mundesi per tu perfshire ne zbatimin e ketij projekti per nje numer shume te madh punonejsish lokale .

10.2 Shkarkimet ne ajer

Gjate fazes ndertimore te TEC:

Masa parandaluese: Punimet e germimeve parashikojne te kryhen duke bere njomje te siperfaqes per te ulur emetimin e grimcave te pluhurit dhe menaxhimin e mases se dheut te gjeneruar gjate germimeve .

Perdorimi me eficence e makinerive qe konsumojne karburant per te ulur konsumin e panevojshem te lendes djegese dhe per rrjedhoje duke ulur dhe sasin e emetimeve te CO₂, SO₂ ,NO_x, HC etj qe emetohen nga djegia e karburanteve .Duke mbajtur parasysht qe zona e propozuar per zhvillimin e projektit ka karakter rural dhe eshte mjaft larg stresit industrial, ndotja e ajrit si pasojë e operacioneve të ndërtimit të veprave inxhinierike dhe qarkullimit të automjeteve vlerësohet të mos i tejkalojë normat e cilësisë së ajrit për qendrat e banuara që përcaktohen në VKM nr.803 datë 04.12.2003 “Për normat e cilësisë së ajrit ”.

- Te gjitha aktivitetet e pastrimit, nivelimit, ndertimit dhe transportit te nderpriten gjate periudhave me ere te forte.
- Te kufizohet shpejtesia e levizjes se kamioneve per ne kalimet tek sheshi ndertimit.

Tabela 10-1: *Normat e cilësisë së ajrit për qendrat e banuara*

Standarti	PM10 (µg/m ³)	TSPM (µg/m ³)	SO ₂ µg/m ³	VOC µg/m ³	NO ₂ µg/m ³	CO µg/m ³	O ₃ µg/m ³
Directive 2008/50/EC of the European Parliament and of the Council of 21 May 2008 on ambient air quality and cleaner air for Europe	60	100	40	5	40	1000	120
VKM Nr.803, date 4.12.2003 “Per normat e cilësisë së ajrit në mjedis”	60	140	60	5	60	2000	65

- **Faza Operacionale e TEC:**

Emetimet me te rendesishme per shkak te operimit te TEC do jene emetimet ne ajer gjate fazës se operimit.

Tabela 10-2: Bilanci i shkarkimeve ne ajër (prurja ne mase)

Te dhena te gazit te shkarkimeve		
	Referuar ajrit me lageshtire	Referuar ajrit te thate
Masa	137.928 kg/sek	130.382 kg/sek

Tabela 10-3: Perbërja e gazrave te shkarkimeve

Përbërja e gazrave te shkarkimeve/ % ne peshe									
Nr	Gazi	Me lageshtire		Ajrit te thate		Me lageshtire		Ajrit te thate	
1	CO2	6.0224	Wt %	6.370962	Wt %	8.306576	Kg/sek	8.306585	Kg/sek
2	N2	73.3195	Wt %	77.56305	Wt %	101.1281	Kg/sek	101.1282	Kg/sek
3	H2O	5.471	Wt %		Wt %	7.546041	Kg/sek	0	Kg/sek
4	O2	13.9419		14.74882	Wt %	19.22978	Kg/sek	19.2298	Kg/sek
5	Ar	1.2451	Wt %	1.317163	Wt %	1.717342	Kg/sek	1.717343	Kg/sek

Masat parandaluese te parashikuara nga zhvilluesi per kontrollin e emetimeve :

Impianti i TEC eshte parashikuar te jete i pajisur me nje sistem alarmi/kontrolli i cili reagon nese dedektoret e gazit zbulojne nivele te larta te emetimeve te gazit ose nese sistemi po pergatitet te çlirojë CO2. Kur sistemi aktivizohet, cilindrat kryesorë të CO₂ shkarkohen në turbinë dhe ndarjet e gjeneratorit nëpërmjet grykave të shumta dhe amortizuesit e ventilimit mbyllen automatikisht. Pas një vonese kohore sigurohet një shkarkim i ngadaltë i zgjatur i CO₂.

Sistemi i Kontrollit të Shpërndarë (DCS), ofron të gjitha veprimet e nevojshme me sisteme kontrolli të dedikuara për komponentë dhe nënsisteme të veçanta.

Si pjesë e sistemit I&C, eshte edhe Sistemi i Monitorimit të Vazhdueshëm të Emisioneve (CEMS) i cili eshte pjese perberese pakete ne gjithe instalimet e nevojshme te TEC(CCPP). Nje set i dedikohet analizave të gazrave të emetuara në periudha të caktuara kohore, ndërsa seti tjetër i dedikohet monitorimit të vazhdueshmes te emetimeve.


Gazrat kryesore qe do monitorohen ne menyre te vazhdueshme sipas kerkesave te ligjeve në fuqi. Ndotësit kryesorë qe do monitorohen janë:

- **NOX (si perqendrim I NO₂)**
- **CO**
- **Oksigjen**

Ndërkohë përdorimi i gazit natyror si lëndë djegëse për prodhimin e energjisë elektrike ka këto avantazhe:

- **Përfitimet mjedisore të gazit natyror**

- Statistikat⁴ vërtetojnë se ka shumë përfitime të gazit natyror. Ndër burimet e energjisë jo të rinovueshme, emetimet nga djegia e tij janë më të ulëta. Emetimet e dioksidit të karbonit janë më të ulëtat me këtë material.



Figurë 10-1:Grafiku i emetimeve ne ajer te CO2 refruar lëndës djegëse qe përdoret në një impiant të prodhimit të energjisë elektrike

Figurë 10-2:Emetimet specifike te CO2 referuar llojit te karbrantit te perdorur per djegie dhe kWh te energjise se prodhuar

Specific CO ₂ -emissions of different fuels In relation to one kilowatthour electricity		
Fuel	Power Plant Efficiency [%]	CO ₂ Emissions ¹⁾ [g CO ₂ / kWh _{el.}]
Lignite	38*	1093
->(Old)	34	1221
->(Modern)	43	966
->(Improved)	51	814
Hard coal	39*	1001
->(Old)	36	1084
->(Modern)	46	849
->(Improved)	48	765
Natural gas	56.1**	433
->New turbine KW	39.2	619
->New construction CCGT	59	411
Natural Gas	Calc:	CO₂ Emissions
Total Greenhouse Effect	Direct ²⁾ + Fugitive Emissions ³⁾	[g CO ₂ -eq. / kWh _{el.}]
-> 1 % methane leakage	(100+25) % · 204 g/kWh _{el.} =	503
-> 2 % methane leakage	(100+50) % · 204 g/kWh _{el.} =	603
-> 3 % methane leakage	(100+75) % · 204 g/kWh _{el.} =	704

⁴ : https://ëëë.volker-quaschnig.de/datserv/CO2-spez/index_e.php

* Mean net electrical efficiency (UBA 2017)

** Mean gross electrical efficiency (UBA 2019)

1) Own calculation from "CO₂ emission factor including upstream chain emissions" (UBA 2019, p.43) / "power plant efficiency" (Llogaritja nga "faktori i emetimit të CO₂ duke përfshirë emetimet e zinxhirit në rrjedhën e sipërme" (UBA 2019, f.43) / "efikasiteti i termocentralit);

2) Own calculation of direct CO₂ emission factor for natural gas: 201 gCO₂/kWhPE (excluding upstream chain emissions); assumption for net electrical efficiency = 50%: (201 g/kWhPE) / 0.5 = 402 g/kWhel. (Llogaritjet vetjake e faktorit direkt të emetimit të CO₂ për gazin natyror: 201 gCO₂/kWhPE (duke përjashtuar emetimet e zinxhirit në rrjedhën e sipërme); supozimi për efikasitetin neto elektrik = 50%: (201 g/kWhPE) / 0,5 = 402 g/kWhel.)

3) Own calculation of fugitive emissions: The release of 1% of the amount of methane needed for 1 kWh of electricity (145 g/kWhel. at 50% efficiency) corresponds to CO₂eq. of 36 grams at GWP = 25. (Llogaritjet vetjake të emetimeve të arratisura: Lëshimi i 1% të sasisë së metanit të nevojshëm për 1 kWh energji elektrike (145 g/kWhel. me efikasitet 50%) korrespondon me CO₂eq. prej 36 gram në GWP = 25.)

Burimi :

- UBA 2021 - Strommarkt und Klimaschutz: Transformation der Stromerzeugung bis 2050 (p. 66)
- UBA 2019 - Emissionsbilanz erneuerbarer Energieträger 2018 (p. 42f.)
- UBA 2017 - Daten und Fakten zu Braun- und Steinkohlen (p. 31f.)

Duke qenë se TEC do të jetë një Leje e tipit A, normat e emetimeve të shkarkimeve do jone në përputhje me kërkesat e ligjit 10448-2011” Per lejet e Mjedisit”;

Për ndotësit specifikë që nuk ka kufizime sipas ligjit 10448 , do t'i referohen kërkesave të VKM Nr. 435, date 12.9.2002 “ Per Miratimin e Normave të Shkarkimeve në Ajër në Republikën e Shqipërisë”;

Impakti i shkaktuar nga emetimet në ajër gjatë fazës ndërtimore dhe operacionale të TEC do duhet të përmbushë kërkesat e cilësisë së ajrit referuar :

VKM Nr.803, date 4.12.2003 “Per Miratimin e Normave të Cilësisë së Ajrit” ;VKN Nr. 352, datë 29.4.2015 “ Për Vlerësimin e Cilësisë së Ajrit të Mjedisit dhe Kërkesat për Disa Ndotës në Lidhje me të”;

Gjithsesi, ky projekt do të përmbushë edhe standartet e kërkuara të emetimit sipas legjislacionit të BE-së.

10.3 Mbetjet e gjeneruara

Mbetjet e ngurta nga faza ndërtimore do grumbullohen dhe menaxhohen sipas llojit , kryesisht mbetje urbane dhe inerte nga punimet e fazës ndërtimore.Ato do të depozitohen në venddepozitimet e miratuara nga pushteti lokal , nepermjet nenkontraktoreve të licensuar për grumbullim , transport, trajtim/ depozitim të mbetjeve .

Të gjitha instalimet e përkohshme të kantierit do të vendosen brenda zonës CAPP në pronësi të pronarit. Kjo përfshinë kampet e punës, zyrat dhe parkimin e makinave ,objektet e punishtes,etc

Me përfundimin e fazës së ndërtimit, të gjitha instalimet e përkohshme do të hiqen dhe çmobilizohen duke e lënë vendin e zënë të pastër dhe pa mbeturina ose ndotje.

➤ Faza operacionale:

Termocentrali me gaz natyror nuk do të prodhojë mbetje të ngurta si hiri ose llumra (te tilla siç krijohen në një TEC qymyrguri) . Mbetjet e ngurta të prodhuara do të jenë minimale dhe në përgjithësi do të jenë si rezultat i aktiviteteve të mirëmbajtjes ose mbajtjes, të cilat mund të përfshijnë artikuj të tillë si:

- Tuba të vjetra, çeliku, kablo, instrumente etj., të zëvendësuara për shkak të riparimeve ose modifikimeve;
- Artikujt e konsumueshëm p.sh. filtra vaji dhe ajri; dhe
- Artikujt e mirëmbajtjes, p.sh. lecka, enë për bojëra ose kimikate etj

Aty ku është e mundur, artikujt do të riciklohen. Përndryshe, mbetjet e ngurta do të grumbullohen dhe trajtohen në deponimin e mbetjeve të qytetit nepermjet subjekteve të licencuara .

➤ **Substancat e rrezikshme dhe toksike:**

Përdorimi i substancave të rrezikshme në termocentral është i kufizuar në kimikatet e përdorura në mirëmbajtjen e përgjithshme të impiantit. Të gjitha kimikatet dhe substancat e rrezikshme do të ruhen në vende të sigurta në vend dhe materialet e mbeturinave do të ruhen transportuar nga vendi për në subjektet e licencuara të asgjësimit të kimikateve.

➤ **Menaxhimi i hidrokarbureve në kantier**

Per te menjanuar ne maksimum riskun e rrjedhjeve aksidentale te karburantit e te lubrifikanteve:

- Investitori nuk duhet te lejoje te perdoren makineri te vjeteruara apo te demtuara.
- Personeli perkates te udhezohet e te pajiset me mjetet e duhura, ne menyre qe edhe ne rast avarish aksidentale te instlimeve qe shoqerohen me rrjedhje te karburantit e te lubrifikantit, te jete ne gjendje t'i menjanojne ato shpejt dhe pa pasoja.

10.4 Ujërat e ndotura dhe shkarkimet

- Ujërat potencialisht të kontaminuara nga rrjedhjet pikimet nga tubacionet , instalimet që mund të kontaminohen do të mblidhen dhe do të dërgohen në një ndarës/ trajtim përpara se të shkarkohen në ujërat pritese.
- Ujërat që mund të kontaminohen me kimikate do të mblidhen dhe do të dërgohen në ujërat e impiantit të trajtimit;
- Efluentët e lëngshëm do të shkarkohen në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza;
- Efluentet nga impianti i trajtimit të ujit (fabrika e ujit të demineralizuar) do të shkarkohen në impianti i trajtimit të ujërave të zeza;

- Zonat ku ruhen vajrat dhe kimikatet do të bashkohen dhe derdhen në një gropë operative të ujërave të zeza për trajtim para shkarkimit në ujra sipërfaqesore;
- Uji i largës së kompresorit do të mblidhet në një rezervuar të dedikuar dhe më pas do të shkarkohen në ujrat pritese.

Zhvilluesi do të jetë përgjegjës për trajtimin e ujrave të shkarkimit. Keto përfshijnë :

- Impianti i trajtimit të ujit të papërpunuar
- Impianti i demineralizimit dhe dezinfektimit për të prodhuar ujë shërbimi dhe ujë të pijshëm , nëse është e nevojshme.
- Sistemi i ujit të pijshëm për objektin.

- Sistemi i trajtimit të ujit të demineralizuar, duke përfshirë impiantin e trajtimit të ujit, depozitimin, pompimin dhe shpërndarja nëse është e nevojshme.
- Sistemi i ujërave të zeza, duke përfshirë trajtimin, ruajtjen, monitorimin dhe asgjësimin e efluentëve/mbeturinave ujë nga objekti.

10.5 Konsum i burimeve natyrore

Konsum i burimeve ujore do sigurohen nepermjet puseve qe do hapen prane zones se projektit. Para hapjes se puseve zhvilluesi do duhet te marre aprovimet perkatese pane baseneve ujore referuar VKM 550 date 15.07.2020, "Per perdorimin e burimeve ujore" per te cilen kerkohen edhe hartime te studimeve relevante te hidrogeologjise, vleresimit te ndikimit ne mjedis etj .

Keto studime do vleresojne nese sasia e ujit te konsumuar per shkak te funksionimit te TEC ,do ndikojte ose jo ne rregjimin e ujrave nentokesore te rajonit. Per kete aktivitet do behet aplikim dhe vleresim te ndikimit ne mjedis te vecante .

10.6 Ndikime ne Zhurma

Masat kunder zhurmes mund te kryhet nepermjet tre nderhyrjeve te mundshme:

- Duke vepruar mbi burimet e zhurmes (duke pakesuar shperhapjen nga burimi ose duke permiresuar kushtet e levizshmerise brenda nje territori te caktuar);
- Duke vepruar ne shumimin e zhurmes efekin kumulativ te saj (duke larguar sa me shume zonat e banimit nga zonat me ndotje te madhe akustike);
- Duke adoptuar sisteme mbrojtjeje pasive (barrier kunder zhurmes) ne ambientet me shume te ekspozuar nga shperndarja e zhurmes.
- Perdorimi i teknikave , I pajisjeve, makinerive konform standarteve te BE qe emetojne nivele zhurme brenda nivelit te lejuar (sipas patentes se prodhuesit) e cila do te minimizoj ndikimin e tyre ne mjedis.Gjithashtu rekomandohet :
- Mirembajtje e paisjeve dhe makinerive qe jane burime emetimi zhurme;
- Monitorimi I niveleve te zhurmave ;
- Aplikimi i brezave mbrojtese ne raste kur vihet re nivele te larta zhurme;
- Gjeleberimi i perimetrit te zones se projektit me peme te larta per te reduktuar perhapje e zhurmave ne mjedis.

Faza Operacionale:

Pajisjet qe emetojne zhurma jane te pajisur me silenciatorë për të zvogëloni emetimet e zhurmës(ref kapitulli i shkarkimeve ne mjedis).

Bazuar ne kerkesat ligjore ,niveli i lejuar i zhurmave⁵ si vijon:

⁵ Udhezim (nr.8, date 27.11.2007) "per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara

Tabela 10-4: Nivelet kufi te zhurmës per mjediset e caktuara

Mjedisi	Efekt kritik ne shendet	LAeq (dBA)	Koha baze (ore)	LAmx Fast (dB)
Zona banimi				
Jashte banese	Bezdi (shqetesim) serioze gjate dites dhe mbremjes	55	16	-
	Bezdi (shqetesim) i moderuar gjate dites dhe mbremjes	50	16	-
Ne brendesi te banesave	Kuptueshmeri e bisedes dhe (bezdi) shqetesim i moderuar gjate dites dhe mbremjes	35	16	-
Ne brendesi te dhomes se	Prishja e gjumit naten	30	8	-
Jashte dhomes se fjetjes	Prishje e gjumit, dritare e hapur (vlera nga jashte)	45	8	-
Institucione				
Klasa mesimi, institucione-mjedise parashkollore (brenda)	Kuptueshmeri e bisedes, veshtiresi ne kuptimin e informacionit, komunikimin e mesazhit	35	Gjate mesimit	-
Dhomat e fjetjes ne kopshte (brenda)	Prishje e gjumit	30	Koha e gjumit	-
Oborri i shkolles, vendet e lojrave ne	Bezdi (shqetesim) - (burime te jashteme)	55	Koha e pushimit	-
Spitale, salla, dhoma (brenda)	Prishja e gjumit naten	30	8	40
	Prishja e gjumit dite dhe ne mbremje	30	16	
Spitale, salla trajtimi (brenda)	Ndikim ne pushim, clodhje	# 1		
Zona me aktivitetet social- ekonomik				
Zona industriale, tregtare, qarkullimi trafiku (miedis i jashtem)	Demtim degjimi	70	24	110
Mjedis urban				
Mjedise publike, te jashtme apo te	Demtim degjimi	85	1	110
Ceremoni, festivale dhe	Demtim degjimi (klientet < 5 here/ vit)	100	4	110
Muzike nepermjet kufjeve te	Demtim degjimi	85 # 4	1	110
Tinguj – zhurme impulsive nga	Demtim degjimi (te rriturit)	-	-	140#2
	Demtim degjimit (femijet)			120#2
Parqe publike				
Parqet natyrore dhe zonat e	Prishje e qetesise	#3		

Spiegime:

LAeq (dBA) = Niveli ekuivalent i matur ne shkallen A

Koha baze (ore) = Koha gjate se ciles behet matja

LAmx Fast (dB) = Niveli i matur ne shkallen A ne menyren Fast (e shpejte)

1 = Sa me e ulet qe te jete e mundur.

2 = Presioni zanor maksimal (LAmx, fast) matur 100 mm larg veshit.

3 = Zonat e jashteme te qeta duhet te mbrohen dhe raporti i zhurmes hyrese/shtese me zhurmen e fonit natyral duhet te ruhet sa me i ulet qe te jete e mundur.

4 = Nen kufjet e degjimit, pershtatur me vlerat fushes se lire.

- **Zonë industrial**

Orët e ditës (07:00 – 22:00) 70 dBA

Orët e natës (22:00 – 07:00) 70 dBA

- **Zonat e banuara dhe insitucionet arsimore edukative**

Orët e ditës (07:00 – 22:00) 55 dBA

Orët e natës (22:00 – 07:00) 45 dBA

Gjate fazes operacionale, (vënies ne shfrytëzim te godinës)

Nuk pritët ndikim lidhur me zhurmat

10.7 Ndikimi Social-Ekonomik i Projektit

Zhvillimi i këtij projekt shoqërohet me efekte pozitive sociale si vijon:

- Energjia e prodhuar konsiderohet si energji me emetimet me te vogla krahasuar me cdo TEC tjetër qe perdor si lende djegese qymyr, naftë.
- Krijon vende pune duke punësuar si ne fazen ndertimore por edhe ne fazen afatgjate te shfrytezimit te TEC gje e ila ndihmon ekonominë e vendit.
- Punësimi i përkohshëm dhe afatgjate për komunitetin i cili do të të marrë pjesë drejtpërdrejt në proceset e ndertimit dhe operimit gjë e cila do të sjellë një kontribut të dobishëm në të ardhurat familjare (hapja e vendeve të punës);
- Rritje të ardhurash për shërbimet shtesë që do të duhet të behen për punonjësit që do te merren me ndërtimin e këtij projekti.

10.8 Impakti visual

Qendrat e banuara jane larg shesheve te ndertimit qe do te thote qe ky impact do jete i reduktuar. Ripërdorimi i masave te dherave qe gjenerohen gjate germimeve ,per sheshime dhe nivelimeve perreth zones se projektit.

Masa reduktuese per mbrojtjen e peisazhit do rekomandohen ne fazat e mevonshme te zhvillimit te projektit , masa te cilat marrin ne konsiderate reduktimin dhe permisimin e peisazhit ne zonen e projektit perfshire ketu edhe gjelberimin e perimetrit te zones se projektit , por jo vetem.

10.9 Impakti ne trashëgimëne kulturore dhe arkeologjike

Faza ndertimore :

Masa parandaluese:

Investitori eshte i detyruar qe, gjate procesit te ndertimit,zbatimit te projektit,të këshillohen me specialistë të Institutit të Arkeologjisë dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës, para fillimit te punimeve per te bere identifikimin e zonave te mbrojtura si trashëgimi kulturore. Specialistët kryejnë kontrollin e zonës dhe përgatisin dokumentacionin përkatës. Kur zona përmban vlera të rëndësishme arkeologjike, etnografike

ose gjurmë të arkitekturës së lashtë ose tradicionale, projekti duhet të ndryshojë. Propozimi për ndryshime bëhet nga institucionet që kanë kryer kontrollin dhe shpenzimet për këto ndryshime përballohen nga investitori.

Kur, pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjike- etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë.


Punonjesit(Kontraktori i punimeve ne terren) që zbulojnë ose gjejnë, në mënyrë të rastësishme, objekte të trashëgimisë kulturore, janë të detyruar që brenda 20 ditëve të njoftojnë organet vendore të kulturës, Institutin e Arkeologjisë dhe Institutin e Monumenteve të Kulturës, duke deklaruar mënyrën dhe vendin e gjetjes. Pas dokumentimit të objektit, komisioni i ngritur për këtë qëllim me specialistë të këtyre institucioneve përcakton vlerat dhe vendos për statusin e mëtejshëm të objektit, si dhe shpërblimin e këtij personi.

Nëse gjetjet janë me vlera të rëndësishme, punimet e filluara mund të pësojnë ndryshime ose të ndërpriten përfundimisht. Vendimi në këtë rast merret nga organi që ka autorizuar fillimin e punimeve.

11. PERFUNDIME

Nga hartimi i vleresimit paraprak të ndikimit në mjedis të projektit të propozuar , mund të konkludojmë që:

- Zona e projektit është e distancuar nga Zonat e Mbrojtura dhe monumentet e natyrës. Ndertimi dhe zhvillimi i këtij projekti nuk impakton asnje nga zonat e mbrojtura apo monumentet e natyrës as në fazë ndertimore as në atë operacionale.
- Rajoni ku propozohet të zhvillohet projektin njihet për traditën në aktivitetin e shfrytëzimit të hidrkarbureve , veçanërisht zona e Patos- Marinzes por edhe Roskoveci.
- Zona e propozuar e projektit gjendet pranë rrjetit ekzistues të infrastrukurës rrugore lokale por edhe asaj kombëtare. Kjo favorizon ndertimin dhe operimin e TEC si dhe lehtëson qarkullimin e mjeteve, burimeve njerëzore , transportin e materialeve për në impiantin e TEC.
- Teknologjia e propozuar për tu zbatuar konsiderohet bashkohore dhe zhvilluesi synon të zbatojë praktikën më të mirë të mundshme si në fazën ndertimore por edhe atë operacionale të krahasueshme me ato të vendeve të EU.
- Trualli që do zihet nga ndertimi i këtij TEC është tokë private në pronësi të zhvilluesit.
- Do të kemi të punësuar në mënyrë indirekte të nënkontraktoreve që do operojnë gjatë fazës ndertimore por edhe nënkontraktore që do ofrojnë shërbime për qëllime operimit të TEC si dhe shërbime për punonjësit që do operojnë në TEC.
- Të ardhura nga taksat për qeverinë lokale dhe qendrore.
- Energjia e prodhuar konsiderohet si energji me emetimet më të vogla krahasuar me ato të TEC tjetër që përdor si lëndë djegëse qymyr, naftë.
- Zona e zgjedhur për ndertimin dhe operimin e këtij projekti nuk bie në ndesh me ndonjë kriter kufizues/ndalues ligjor ambiental. Zona dhe teknologjia e propozuar për projektin konsiderohet një alternativë e mirë për zhvillimin e këtij projekti duke marrë në konsideratë avantazhet e afërsisë së zonës me vendodhjen e lëndës së parë (tubacioni TAP) , me infrastrukturën ekzistuese , si dhe me traditën e hershme të rajonit në zhvillimin e industrisë hidrokarbure .
- Ky projekt nuk bie në ndesh me planin kombëtar apo me zonat me rëndësi të veçantë kombëtare .
- Nga analizimi i përmbajtjes së këtij raporti mund të konkludojmë që implementimi i këtij projekti nuk do të ketë impakte negative sinjifikative në mjedisin përreth zonës së projektit gjatë fazës së ndertimit dhe operimit të tij.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT**

Nr. 136 Prot.

Tirane, me 19.05. 2004

Vendimi Nr.6, Nr.011 Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":


Znj.Manushaqe JACE

Certifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Ethem RUKA





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5006 Prot.

Tiranë, më 22.06 2017

Nr. identifikues 512

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. DRITAN BRATKO

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI


Lefter KOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

LICENCE

Numri serial: LN-2485-01-2017
NUIS/NIPT: K61814023M

Subjekti: ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njesia Bashkiake nr 5, Rruga Sami Frasheri, 50 m mbi shkollen Petro Nini Luarasi, Pallati Bjorn, Kati 11

Kodi: III.2.A ()

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 17/01/2018

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor. Ndikim në mjedis)

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënshkrimi i sportelit

